



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE  
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO  
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

# RAPORTI VJETOR

2023



2021

2019

RAPORTI VJETA  
2018

RAPORTI VJETA  
2017

BB



# PËRMBAJTJA

<b>04</b>	<b>PJESA I - INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME</b>
06	FJALA E KRYESUESIT TË BORDIT DHE E DREJTORIT MENAXHUES
08	AKRONIMET
09	PËRMBLEDHJE E TREGUESVE OPERACIONALË
<b>10</b>	<b>PJESA II - PROFILI I INSTITUCIONIT</b>
12	THEMELIMI DHE STATUSI I FKGK-SË
12	MISIONI
13	VLERAT INSTITUCIONALE
<b>14</b>	<b>PJESA III - QEVERISJA KORPORATIVE</b>
16	BORDI I DREJTORËVE DHE PERSONELI
18	STRUKTURA ORGANIZATIVE
18	KORNIZA LIGJORE
19	BORDI I DREJTORËVE
19	KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE
20	TAKIMET E BORDIT TË DREJTORËVE DHE TË KOMITETEVE PËRKATËSE
<b>22</b>	<b>PJESA IV - BASHKËPUNËTORËT E FKGK-së</b>
24	BASHKËPUNËTORËT E FKGK-SË
25	AECM
<b>26</b>	<b>PJESA V - PERFORMANCA E FKGK-së</b>
28	ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË GARANCIVE
30	SKEMAT GARANTUESE TË FKGK-SË
30	DRITARJA STANDARDE
31	DRITARJA AGRO
32	GROW
33	DRITARJA E EKSPORTIT
34	DRITARJA GRATË NË BIZNES
35	DRITARJA START-UP
36	SHTUESHMËRIA - 2023
38	MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR
41	KUALITETI I PORTOFOLIT
43	STRUKTURA E KAPITALIT
45	QEVERISJA MJEDISORE DHE SOCIALE
47	PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTIMI I FINANCIMIT TË TERRORIZMIT
<b>48</b>	<b>PJESA VI - VEÇORITË E VITIT 2023</b>
50	PARTNERITETI I FKGK-së ME SIDA
50	DRITARET GRATË NË BIZNES DHE STARTUP
51	KOMPONENTA JO FINANCIARE
52	MBYLLJA E PROJEKTIT TË BANKËS BOTËRORE PËR FUQIZIMIN E SEKTORIT FINANCIAR
53	PROJEKTI EIB
<b>54</b>	<b>PJESA VII - AKTIVITETET GJATË VITIT 2023</b>
56	AKTIVITETET E FKGK-së
63	FUSHATAT E FKGK-së NË 2023
64	STORIET E SUKSESIT
<b>70</b>	<b>PJESA VIII</b>
72	PASQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA

# PJESA I





INFORMACIONE  
TË PËRGJITHSHME

# FJALA E KRYESUESIT TË BORDIT DHE E DREJTORIT MENAXHUES

Të nderuar,

Ndërsa reflektojmë mbi rrugëtimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore përgjatë vitit të kaluar, me shumë kënaqësi ju prezantojmë raportin vjetor të radhës, si përmbledhje e të arriturave dhe sfidave të institucionit tonë për vitin 2023.

Ashtu si edhe përgjatë tërë historisë së shkurtër tetë vjeçare, edhe këtë vit ne treguam që jemi institucion dinamik, lehtë i adaptueshëm dhe që vazhdimisht reflekton në kërkesat dhe nevojat e ndërmarrjes së private. Avancimi i vazhdueshëm i dritareve garantuese ekzistuese, si dhe dizajnimi dhe lansimi i atyre të reja, si instrument me rëndësi për lehtësimin e qasjes në financa për NMVM-të, vazhdon të mbetet objektivë parësore institucionale. Mendojmë që ky agjilitet institucional, e që burimin e ka në komunikimin e vazhdueshëm me bankat partnere, dhe komunitetin e biznesit, e që është kultivuar me plot vullnet nga një staf profesional dhe i përkushtuar në FKGG, është njëra nga pikat më të forta të institucionit tonë.

Viti 2023, ishte vit për tu mbajtur mend, dhe atë për arsyen sepse në këtë vit kemi lansuar dy skema të reja garantuese; Dritaren për ndërmarrës të rinj dhe Dritaren për gratë në biznes, derisa në pjesën e dytë të vitit zgjeruam partneritetin e bashkëpunimit, në kuadër të Dritares GROW edhe me katër banka tjera partnere.

Po ashtu, vlen të theksohet që në kuadër të dritares dedikuar grave në biznes dhe dritares dedikuar ndërmarrësve të rinj, për herë të parë në tremujorin e tretë të vitit 2023, kemi prezantuar komponentën jofinanciare, iniciativë kjo që përmbanë trajnime dhe mundësi për zgjerim të njohurive për menaxhim financiar të biznesit, i dizajnuar për pronaret dhe udhëheqesit përfitues nga këto dy dritare. Është kjo një risi në kuadër të programeve tona, e cila e kombinuar me garancionet kreditore, si komponentë financiare, do ti adreson tri probleme kronike përgjatë

rrugës së zhvillimit të tyre, që i kanë përcjellë në vazhdimësi këto segmente të tregut: kompenzim i mungesës së historisë kreditore; përvojës në biznes, si dhe mungesës së kolateralit.

E gjitha kjo me qëllim që përmes zgjerimit të njohurive që lidhen me financat, pronaret gra të bizneseve apo ndërmarrësit e rinj, të mbijetojnë suksesshëm në rrugën e zhvillimit të biznesit të tyre, si dhe të rrisin transparencën financiare ndaj kreditorit potencial e që pastaj do të rezultojnë në afrimin e relacionit kreditor – debitor. Nga këto programe trajnuese, dedikuar për ndërmarrjet e udhëhequra nga gratë dhe ndërmarrësit e rinj, gjatë vitit të kaluar, kanë përfituar hiq më pak se 300 pjesëmarrës.

Gjithashtu, viti i kaluar karakterizohet me një progres të dukshëm edhe në rritjen e dinamikës së regjistrimit të garancive të reja, duke e bërë këtë vit ndër më të mirët, përgjatë gjithë historisë së ekzistimit tonë. Sigurisht, një progres i tillë, padyshim vjen nga rritja e vazhdueshme e bazës së kapitalit të institucionit dhe bashkëpunimi i shkëlqyeshëm i kultivuar tanimë vite me rradhë me institucionet e regjistruara financiare dhe me komunitetin e biznesit. Sidoqoftë një rol të veçantë ka luajtur edhe qasja proaktive e institucionit tonë në rritjen e numrit të dritareve garantuese, të dizajnuara enkas për të adresuar nevojat specifike të segmenteve të caktuara të tregut.

Dritaret garantuese të FKGG-së kanë rritur mundësinë që më shumë ndërmarrje, duke përfshirë edhe ato që deri më tani kanë pasur veshtirësi në qasjen në financa, të kualifikojnë dhe të përfitojnë nga dritaret tona garantuese.

E gjitha kjo ka bërë të mundur që brenda periudhës një vjeçare të vitit të kaluar kreditimi i ndërmjetësuar për NMVM-të, të arrijë në 120 milionë euro shpërndarë në 2,216 kredi duke lehtësuar kështu qasje në financa për 1,978 NMVM.

Viti 2023 shënon edhe realizimin e marrëveshjes së ri-garancisë me Sida, e dyta me radhë me këtë partner shumë të rëndësishëm për FKGK-në, në vlerë totale prej 14.9 milionë eurosh. Ky instrument rigarantues do të dedikohet për mbështetjen e kreditimit të tri segmenteve të caktuara të tregut, dhe atë për; gratë në biznes, ndërmarrjet eksportuese dhe për investimet e gjelbra. Benefitet do të jenë të nduarnduarshme, për bankat partnere, ndërmarrjet përfituese dhe vet FKGK-në.

E gjitha kjo duke aluduar në vlerën e investimeve që kjo marrëveshje planifikohet të mobilizojë e që parashikimet tregojnë vlerën prej 55 milionë euro, derisa në anën tjetër do të ndikoj drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të garancioneve kreditore nga FKGK për IRF-të. Kjo do të jetë një mundësi e mirë për të përmirësuar edhe kushtet e kreditimit për përfituesit e fundit.

Jo me pak e rëndësishme për tu përmendur, gjatë vitit 2023 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore vazhdoi me implementimin e marrëveshjes me Bankën Evropiane për Investime (EIB) të nënshkruar më 28 qershor 2021 ndërmjet EIB dhe Ministrisë së Financave të Kosovës, në vlerë prej 40 milionë euro. Kjo marrëveshje që është arritur në kuadër të masave të QRK-së, për të mbështetur ndërmarrjet private drejt rikuperimit nga kriza e pandemisë COVID19, brenda një

viti implementues rezultoi në mbështetjen e 45,960,300 euro kredi të aprovuara në gjithsej 705 kredi. Derisa në të njëjtën kohë ka sjellë rritje të kapitalit për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore nga 57,735 milionë euro në 2022 në vlerë të kapitalit 80,366 në vitin 2023.

Viti 2023 ishte edhe vit kur përfundoi projekti i Bankës Botërore për Fuqizimin e Sektorit Financiar (FSSP), projekt ky që ka rritur kapitalin e rregullt të FKGK-së, si dhe ka ndihmuar institucionin në fuqizimin e kapaciteteve njerëzore, si dhe në sjelljen e përvojave më të mira në lëmin e Qeverisjes Mjedisore e Sociale; Menaxhimit e riskut kreditor, të prokurimit, si dhe rritjen e kapitalit të rregullt të FKGK-së.

Ndërsa vazhdojmë rrugëtimin tonë në kompleksitetin e një ambientit të jashtëm ku viteve të fundit është ballafaquar me shumë të papritura serioze, ne do të mbetemi të palëkundur në angazhimin tonë për të shërbyer si katalizator dhe partner kyesor për ndërmarrjet private në Republikën e Kosovës, për të ndihmuar tejkalimin e të gjitha sfidave ekzistuese dhe atyre të reja. Përmbajtja e këtij raporti vjetor shërben si një testament për qëndrueshmërinë tonë si institucion, vendosmërinë dhe besimin e palëkundur në fuqinë transformuese të sipërmarrjeve që kanë vizion.

**AGAN AZEMI**

KRYESUES I BORDIT TË DREJTORËVE

**BESNIK BERISHA**

DREJTOR MENAXHUES

# AKRONIMET

<b>AECM</b>	ASOCIACIONI EVROPIAN I INSTITUCIONEVE GARANTUESE
<b>ARBK</b>	AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BINESEVE TË KOSOVËS
<b>ASK</b>	AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
<b>BD</b>	BORDI I DREJTORËVE
<b>BQRK</b>	BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
<b>DFC</b>	KORPORATA FINANCIARE E ZHVILLIMIT NDËRKOMBËTAR - SHBA
<b>FKGK</b>	FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
<b>EIB</b>	BANKA EVROPIANE PËR INVESTIME
<b>EIF</b>	FONDI EVROPIAN PËR INVESTIM
<b>GROW</b>	DRITARJA E MUNDËSIVE PËR RIMËKËMBJE TË GJELBËR
<b>IF</b>	INSTITUCIONI FINANCIAR
<b>IFJB</b>	INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE
<b>IPF</b>	INSTITUCIONET PARTNERE FINANCIARE
<b>IRF</b>	INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE
<b>IFRS</b>	STANDARDI NDËRKOMBËTAR PËR RAPORTIM FINANCIAR
<b>IMF</b>	INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE
<b>KFW</b>	BANKA ZHVILLIMORE GJERMANE
<b>KJP</b>	KREDITË JOPERFORMUESE
<b>KMR</b>	KOMITETI PËR MENAXHIM TË RISKUT
<b>KA</b>	KOMITETI I AUDITIMIT
<b>MCC</b>	KORPORATA E SIFIDAVE TË MILENIUMIT
<b>MFPT</b>	MINISTRIA E FINANCAVE PUNËS DHE TRANSFEREVE
<b>MFK</b>	FONDACIONI I MILENIUMIT TË KOSOVËS
<b>MINT</b>	MINISTRIA E INDUSTRISË NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË
<b>MTI</b>	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRISË
<b>NMVM</b>	NDËRMARRJE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME
<b>PFSF</b>	PROJEKTI PËR FUQIZIMIN E SEKTORIT FINANCIAR
<b>PMMS</b>	POLITIKA E MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
<b>PRE</b>	PAKO E RIMËKËMBJES EKONOMIKE
<b>QRK</b>	QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
<b>SIDA</b>	AGJENCIA SUEDEZE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR
<b>SMMS</b>	SISTEMI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
<b>SHBK</b>	SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
<b>USAID</b>	AGJENCIA AMERIKANE PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR



# PËRMBLEDHJE E TREGUESVE OPERACIONALË

TREGUESIT KRYESORË OPERACIONALË	DHJETOR 2022	DHJETOR 2023
<b>KAPITALI</b>	<b>57,735,311</b>	<b>81,292,962</b>
Potenciali garantues	<b>213,145,173</b>	<b>216,701,975</b>
*Limitet e alokuara	<b>138,241,670</b>	<b>158,541,106</b>
Shkalla e shfrytëzimit të limiteve	<b>84.4%</b>	<b>77.40%</b>

<b>BILANCI I GARANCIVE</b>	<b>116,269,160</b>	<b>116,245,060</b>
Nr. i kredive aktive të garantuara	<b>6,916</b>	<b>7,105</b>
Nr. i IRF-ve partnere	<b>12</b>	<b>12</b>
Mesatarja e garancive kreditore në portofolin e FKGK-së	<b>22,309</b>	<b>23,042</b>
Mesatarja e maturitetit të garancive kreditore në portofolin e FKGK-së	<b>37</b>	<b>37</b>
KJP (në %)	<b>1.94%</b>	<b>2.83%</b>
Mbulueshmëria e KJP-së me provizionim (në %)	<b>131.2%</b>	<b>139.04%</b>

<b>KAPITALI I INVESTUAR</b>	<b>60,690,832</b>	<b>78,386,300</b>
-----------------------------	-------------------	-------------------

Vlerat monetare janë në euro

\* Në limitet e alokuara përfshihen ekspozimet në dritaret aktive si dhe dritaret e mbyllura deri më 31.12.2023.

# PJESA II

The image features a minimalist design with several overlapping, wavy, organic shapes in shades of teal and light blue. The shapes are layered, creating a sense of depth and movement. The top left corner contains the text 'PJESA II' in a clean, sans-serif font. The overall aesthetic is modern and clean.



# PROFILI I INSTITUCIONIT

# THEMELIMI DHE STATUSI I FKGK-SË

Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë është institucion i pavarur, i themeluar me qëllim që të lehtësojë ndërmjetësimin financiar për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-ve), përmes ofrimit të garancioneve kreditorë për institucione financiare të regjistruara.

FKGK-ja është themeluar në janar të vitit 2016, duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë. Ligji mbi themelimin e FKGK-së është sponsorizuar nga MTI-ja, me përkrahje të USAID-it përmes programit "Fuqizimi i mbështetjes kreditorë" dhe Bankës Zhvillimore Gjermane (KfW). Ligji për FKGK-në ka hyrë në fuqi më 23 janar 2016, ndërsa aktivitetin operacional institucioni i FKGK-së e ka nisur në muajin shtator të po atij viti.

## MISIONI

Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë është entitet juridik i pavarur me karakter zhvillimor, i cili ofron garanci kreditorë për NMVM-të, duke ndarë rrezikun kreditor me institucionet e regjistruara financiare. Përmes garantimit të portofolit kreditor të institucioneve financiare, ne synojmë rritjen e qasjes në financa për NMVM-të, mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrësisë, mbështetjen e prodhimit vendor dhe të atyre shërbimeve, të cilat krijojnë vlerë të shtuar, krijimin e vendeve të reja të punës dhe mbështetjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik.

Ne jemi të përkushtuar ndaj menaxhimit të qëndrueshëm korporativ dhe ndaj përgjegjësisë sociale që vjen me të. Duke i koordinuar aktivitetet me partnerët tanë: donatorët, institucionet financiare dhe rregullatorët lokalë, përipiqemi t'u shërbejmë interesave afatgjatë ekonomike të vendit, komunitetit të biznesit dhe shoqërisë sonë në përgjithësi.





## VLERAT INSTITUCIONALE

Vlerat institucionale të FKGK-së, të cilat frymojnë brenda institucionit, si dhe shërbejnë për ndërtimin e praktikave të përditshme në punë, sigurojnë udhërrëfim që aktivitetet tona afariste do të kenë një nivel të lartë të përgjegjshmërisë dhe do të jenë në përputhje me standardet më të larta etike dhe morale.

### TRANSPARENCA

Duke qenë institucion në interes publik, FKGK-ja konsideron si shumë të rëndësishëm shpaltosjen e informacionit lidhur me praktikën e punës, politikën dhe rezultatet financiare e operative të institucionit, me partnerët, me palët e tjera të interesit, si dhe me publikun e gjerë.

### PARTNERITETI DHE BASHKËPUNIMI

Ndërtimi i marrëdhënieve të shëndosha, duke u bazuar në transparencë dhe në përgjegjshmëri me partnerët tanë, ndihmon në arritjen e objektivave të përbashkët, në ndërtim të besueshmërisë dhe i respektit të ndërsjellë.

### OBJEKTIVITETI DHE PAVARËSIA NË VENDIMMARRJE

FKGK-ja ruan objektivitetin dhe pavarësinë në vendimmarrje, duke u bazuar në ligjin për themelimin e FKGK-së; në parimet e përgjithshme të qeverisjes korporative, si dhe standardeve më të larta etike dhe profesionale.

### PËRKUSHTIMI

Punonjësit e FKGK-së me përkushtim dhe me profesionalizëm mundohen të realizojnë misionin dhe objektivat e saj, duke besuar në rolin dhe në ndikimin pozitiv, që institucioni do ta ketë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

### PUNA EKIPORE DHE PROFESIONALIZIMI NË PUNË

FKGK-ja ka një ekip profesionistësh, të cilët bashkëpunojnë mbi bazat e respektit të ndërsjellë. Puna ekipore për zgjidhjen e problemeve dhe marrjes së iniciativave, komunikimi i hapur dhe ndarja e përvojave profesionale në mes vete, janë bazamenti i suksesit të FKGK-së. Integriteti dhe dinjiteti personal janë vlera që e përcjellin secilin personel në vazhden e realizimit të detyrave dhe të iniciativave në punë, pa bërë asnjë kompromis në respektimin e këtyre parimeve.

### VLERAT MORALE DHE ETIKE

Me qëllim të vendosjes së parimeve dhe të rregullave brenda institucionit, dhe në marrëdhënie me palët e treta, puna e FKGK-së bazohet në Kodin e Qeverisjes Korporative dhe Kodin e Etikes së institucionit.

# PJESA III

The background features several overlapping, wavy, organic shapes in shades of teal and light blue. A prominent, darker teal line curves across the lower half of the page, while lighter, semi-transparent shapes create a layered, flowing effect behind it.



**QEVERISJA  
KORPORATIVE**

# BORDI I DREJTORËVE DHE PERSONELI

FKGK-ja qeveriset nga një Bord Drejtorësh në përbërje prej shtatë (7) anëtarësh:

- A. një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare, i emëruar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Republikës së Kosovës;
- B. një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare, i emëruar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës;
- C. katër (4) anëtarë të pavarur, të zgjedhur nga donatorët; dhe
- D. Drejtori Menaxhues i FKGK-së, sipas detyrës zyrtare.

## ANËTARËT E BORDIT TË DREJTORËVE TË FKGK-SË NË VITIN 2023:

**AGAN  
AZEMI**

Kryesues i Bordit<sup>1</sup>



**MELIH  
ÇADIRCI**

Anëtar i pavarur i Bordit



**ARTA  
HOXHA**

U.D. Kryesuese  
e Bordit<sup>2</sup>



**ANILA  
STATOVCI  
DEMAJ**

Anëtare e pavarur  
e Bordit<sup>3</sup>



**BESNIK  
BERISHA**

Drejtor menaxhues  
i FKGK-së



**SALVADOR  
ELMAZI**

Anëtar i Bordit sipas  
detyrës zyrtare



**KRESHNIK  
KURTISHI**

Anëtar i pavarur  
i Bordit



**ZEF  
DEDAJ**

Anëtar i Bordit sipas  
detyrës zyrtare



1 Nga data 21.09.2023 z. Agan Azemi u zgjodh Kryesues i Bordit të FKGK-së

2 Deri me datë 22.09.2023 znj. Arta Hoxha ishte U.D. Kryesuese e Bordit të FKGK-së

3 Nga data 21.09.2023 znj. Anila Statovci Demaj u zgjodh anëtare e pavarur e bordit të FKGK-së



# PERSONELI

EKIPI  
I FKGGK-SË  
NË VITIN  
2023:

**BESNIK  
BERISHA**

Drejtor menaxhues



**ALBAN  
KASTRATI**

Menaxher i lartë i rrezikut



**VJOSA  
BALAJ**

Menaxhere e lartë për  
financa dhe administratë



**NORA  
ARIFI**

Menaxhere e lartë  
e portofolit



**KASTRIOT  
KËPUSKA**

Menaxher i projektit



**VILSON  
UKAJ**

Specialist i lartë ligjor dhe  
sekretar i Bordit të Drejtorëve



**BLERT  
GJINOLLI**

Specialist mjedisor  
dhe social



**VERË  
KADRIU**

Zyrtare për administratë  
dhe përkthime



**BURBUQE  
GURI**

Specialiste e kontrollit



**ANITA  
TOÇI**

Specialiste për komunikim  
dhe marrdhënie me publikun



**ALBULENA  
LUBISHTANI**

Specialiste për monitorim  
dhe evaluim



**AGNESA  
BROQI**

Specialiste për  
menaxhim financiar




**AULONA  
SELISHTA**

Specialiste për raportim dhe  
menaxhim të të dhënave<sup>4</sup>



<sup>4</sup> Nga data 14 mars 2023 znj. Aulona Selishta i është bashkangjitur ekipit të FKGGK-së

# STRUKTURA ORGANIZATIVE



## KORNIZA LIGJORE

FKGK, si institucion juridik i pavarur, autonom, i themeluar me ligj të posaçëm, ka autonomi të plotë operationale, administrative, por edhe për sa i përket nxjerrjes së legjislacionit sekondar. Ai funksionon jashtë kuadrit të strukturave qeveritare të Kosovës dhe Shërbimit Civil të Kosovës. Në kuadër të kësaj, FKGK miraton statutin, politikat, procedurat, udhëzimet dhe aktet tjera të brendshme, që përbëjnë kornizën ligjore sekondare të institucionit. Në baza vjetore, FKGK bën rishikimin e akteve të brendshme nënligjore me qëllim të vlerësimit të nevojës për modifikimin e tyre apo hartimin e ndonjë akti të ri nënligjor që i përgjigjet dinamikës së punës së institucionit, si dhe për rregullimin e çështjeve të përcaktuara në objektivat dhe aktivitetet e tij.

Në vitin 2023, me qëllim të përshtatjes me objektivat strategjike të institucionit dhe marrëveshjet e

nënshkruara me palët e treta, FKGK modifikoi pjesën më të madhe të legjislacionit sekondar. Si rezultat, Bordi i Drejtorëve miratoi nëntë (9) politika dhe një (1) procedurë. Është miratuar Procedura për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, që përkufizon rregullat për sinjalizimin, të drejtat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve dhe procedurën e trajtimit të rasteve të sinjalizimit në FKGK. Gjatë vitit 2023, me qëllim të shpërndarjes së rrezikut për portofolet e garantuara, FKGK ka nënshkruar Marrëveshjen e Portofolit të Ri-Garancisë me Agjencinë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA). Ndër vendimet e rëndësishme të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2023 ishin: 1). Miratimi i Marrëveshjes së Portofolit të Ri-garancisë mes SIDA-s dhe FKGK-së; 2). Miratimi i Dritares për Start-Ups dhe Gratë në Biznes, 3) Rishikimi dhe miratimi i Dritares GROW.

# BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve është një nga organet e FKGK-së dhe përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve. Bordi mbledhet së paku katër (4) herë në vit. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, profesionale dhe kolegjiale, në interesin më të mirë të FKGK-së. Bordi i Drejtorëve është organ vendimmarrës dhe mbikëqyrës i punës së institucionit. Përgjegjësitë e Bordit, mes terash, janë: regjistrimi i institucioneve financiare për pjesëmarrje në garancitë kreditore të FKGK-së dhe hyrje në marrëveshjen e garancisë me institucionet e regjistruara financiare, hyrja në marrëveshje të huamarrjes me institucione ndërkombëtare financiare për rritjen e kapitalit dhe në mekanizma ri-sigurimi apo ri-garantimi. Bordi, po ashtu, miraton buxhetin vjetor dhe pasqyrat financiare të institucionit, politikën dhe strategjinë e investimeve të kapitalit, statutin, politikat, procedurat, rregullat dhe udhëzimet për menaxhimin dhe operimin e FKGK-së, si dhe ka përgjegjësi tjera të përcaktuara në Ligjin për themelimin e FKGK-së.

## KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve themelon komitete që mbështesin punën e tij. Komitetet e Bordit analizojnë çështjet brenda fushëveprimit të tyre, monitorojnë aktivitetet e institucionit në fushat ku kërkohen diskutime më të fokusuar, të specializuara dhe teknike dhe për punën e tyre i raportojnë Bordit. Aktualisht, Bordi ka themeluar Komitetin e Menaxhimit të Riskut dhe Komitetin e Auditimit si komitete të përhershme.

**KOMITETI I MENAXHIMIT TË RISKUT** është themeluar në bazë të Ligjit për FKGK-në. Komiteti i Menaxhimit të Riskut ndihmon Bordin e Drejtorëve me fokus në fushën e menaxhimit të riskut. Komiteti i Menaxhimit të Riskut mbledhet së paku çdo tre muaj dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë të Bordit, përderisa menaxheri i lartë i riskut është pjesëmarrës i përhershëm i Komitetit. Komiteti ka përgjegjësi që t'i shqyrtojë politikat e riskut kreditor dhe operativ, mbikëqyrë zhvillimet e portofolit të garantuar dhe të sigurojë që profili i riskut kreditor është në përputhje me politikat kreditore, ligjet dhe rregulloret e zbatueshme.

**KOMITETI I AUDITIMIT** është themeluar në bazë të Ligjit për FKGK-në. Komiteti i Auditimit përbëhet nga katër (4) anëtarë të Bordit dhe takimet mbahen në baza tremujore. Ky komitet është përgjegjës për dhënien e rekomandimeve për Bordin e Drejtorëve për çështjet e menaxhimit të rrezikut, të kontrollit të brendshëm, pasqyrave financiare, kërkesave të pajtueshmërisë, auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe funksione të tjera relevante të qeverisjes së FKGK-së. Përveç kësaj, Komiteti i Auditimit rishikon kontrollet e brendshme financiare, operative dhe administrative.

# TAKIMET E BORDIT TË DREJTORËVE DHE KOMITETET PËRKATËSE

Gjatë vitit 2023, Bordi i Drejtorëve i FKGGK-së mbajti gjithsej pesë (5) mbledhje të rregullta. Në mbledhjet e bordit janë marrë disa vendime të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të FKGGK-së, dhe marrëdhëniet e FKGGK-së me palët e treta.

*Tabela në vijim paraqet mbledhjet e Bordit dhe të komiteteve ndihmëse të Bordit të Drejtorëve të FKGGK-së:*

Orari i mbledhjeve të Bordit	Pjesëmarrja e anëtarëve të Bordit	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve të marra
24 shkurt 2023	7/7	16	13
28 prill 2023	5/7	10	7
23 qershor 2023	5/7	16	9
22 shtator 2023	7/7	24	17
24 nëntor 2023	7/7	16	9
<b>Gjithsej:</b>		<b>98</b>	<b>55</b>

## MBLEDHJET E KOMITETIT PËR MENAXHIM TË RISKUT KREDITOR DHE TË KOMITETIT TË AUDITIMIT

Gjatë vitit 2023 Komiteti për Menaxhim të Rrezikut Kreditor (MRK) mbajti pesë (5) mbledhje të rregullta. Po aq mbledhje të rregullta mbajti edhe Komiteti i Auditimit (KA). Në këto takime komitetet përkatëse nxorën vendime dhe rekomandime për menaxhmentin e FKGGK-së dhe për miratimin përfundimtar nga Bordi i Drejtorëve i FKGGK-së.

*Tabela në vijim paraqet mbledhjet e komitetit të menaxhimi të riskut:*

Orari i mbledhjeve të KMR-së	Pjesëmarrja e anëtarëve të KMR-së	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve/ i rekomandimeve të marra
08 shkurt 2023	2/3	7	2
05 prill 2023	3/3	4	-
07 qershor 2023	3/3	8	2
06 shtator 2023	3/3	8	2
08 nëntor 2023	4/3	7	2
<b>Gjithsej:</b>		<b>34</b>	<b>8</b>

*Tabela në vijim paraqet mbledhjet e komitetit të auditimit:*

Orari i mbledhjeve të KA-së	Pjesëmarrja e anëtarëve të KA-së	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve/ i rekomandimeve të marra
10 shkurt 2023	3/3	5	1
14 prill 2023	3/3	5	-
09 Qershor 2023	3/3	5	-
02 tetor 2023	3/3	5	-
10 nëntor 2023	3/3	4	-
<b>Gjithsej:</b>		<b>24</b>	<b>1</b>



# PJESA IV

The background features several overlapping, wavy, organic shapes in shades of teal and light blue. These shapes flow from the top right towards the bottom left, creating a sense of movement and depth. The colors are soft and muted, contributing to a clean, modern aesthetic.



# BASHKËPUNËTORËT E FKGGK-së

# BASHKËPUNËTORËT E FKGGK-SË

Për t'i arritur objektivat dhe synimet FKGGK-ja bashkëpunon me Qeverinë e Republikës së Kosovës, me Bankën Qendrore të Kosovës, donatorët, institucionet financiare (bankat, IMF-të, IBJF-të), dhe me Komunitetin e NMVM-ve.

## DONATORËT

- Qeveria e Republikës së Kosovës
- Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID
- Banka Zhvillimore Gjermane - KfW

## BASHKËPUNËTORËT

- Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar e përfaqësuar nga Ambasada Suedeze - Sida
- Banka Botërore
- Fondi Evropian për Investime - EIF
- Fondacioni Kosovar i Mileniumit / Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit - MFK/MCC
- Banka Evropiane për Investime - EIB

## INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE

### INSTITUCIONET BANKARE

- Banka Ekonomike
- Banka Kombëtare Tregtare
- Banka për Biznes
- NLB Banka
- ProCredit Bank
- Raiffeisen Bank
- TEB

### INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE

- AFK
- FINCA
- KEP
- KRK

### INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE

- Raiffeisen Leasing Kosovë



AECM është shoqatë Evropiane e Institucioneve Garantuese, e themeluar në vitin 1992. Deri në fund të vitit 2023 numëroi gjithsej 48 anëtarë që operojnë në 31 vende të ndryshme të Evropës. Që nga viti 2018, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) përfaqëson Kosovën brenda familjes së AECM-së.

Anëtarët e AECM-së janë ilustruar në hartën në vijim.



AECM-ja, me bazë në Bruksel, u themelua në vitin 1992 me tri objektiva kryesore:

1. Përfaqësim politik i anëtarëve të saj në institucione të BE-së, Grupit EIB, OECD etj.;
2. Organizimi i shkëmbimit të praktikave më të mira ndërmjet anëtarëve të AECM;
3. Promovimi i instrumentit të garancisë. Anëtarët e AECM-së janë ose skema të garancive të sektorit privat ose institucione publike promovuese ose banka zhvillimore.

Misioni i tyre është të mbështesin NMVM-të në qasje më të lehtë në financa, d.m.th. ofrojnë garanci për NMVM-të që posedojnë një projekt ekonomikisht të shëndoshë, por që nuk disponojnë kolateral të mjaftueshëm bankar. I ashtuquajturi boshllëk i financimit i NMVM-ve që e zgjidhin institucionet garantuese, njihet si dështim i tregut. Duke garantuar për këto ndërmarrje, institucionet e garancisë ndihmojnë në adresimin e këtij dështimi të tregut dhe lehtësojnë qasjen në financa për NMVM-të.

# PJESA V

The image features a minimalist design with several overlapping, wavy, organic shapes in shades of teal and light blue. The shapes are layered, creating a sense of depth and movement. The top left corner contains the text 'PJESA V' in a clean, sans-serif font. The overall aesthetic is modern and serene.



# PERFORMANCA E FKGGK-së

# ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË GARANCIVE


Viti 2023 ka shënuar progres të dukshëm në zhvillimin e portofolit tonë të garancive, duke e shënuar si një vit edhe më të mirë krahasuar me vitin paraprak. Një progres i tillë krahasuar me një vitin paraprak, padyshim vë në pah rritjen e besimit të institucioneve të regjistruara financiare në mekanizmat tanë të garancisë por edhe mënyrën e ofrimit të garancive nëpërmjet dritareve të përshtatura karakteristike dhe nevojave të NMVM-ve përkatëse. Kreditimi i ndërmjetësuar për NMVM-të gjatë këtij viti ishte 120 milionë euro shpërndarë në 2,216 kredi duke lehtësuar kështu qasje në financa për 1,978 NMVM.

Shuma kumulative e kredive të miratuara në fund të vitit arriti vlerën prej 626.4 milionë eurosh për 10,157 NMVM, e mbështetur nga një shumë kumulative e garancive prej 329.47 milionë euro. Vlera totale e mbetur e portofolit të kredive, në fund të vitit 2023, ishte 220.5 milionë euro, përderisa vlera totale e mbetur e portofolit të garantuar ishte 116.25 milionë euro shpërndarë në 7,105 kredi aktive. Sektori më dominues në portofolin e kredive të garantuara gjatë vitit 2023 ishte ai i tregtisë me pakicë dhe me shumicë me 42%, i vijuar nga shërbimet me 23%, prodhimi me 20%, ndërtimtaria me 8% dhe bujqësia me 7%. Në krahasim me një vit më parë,


lëvizja nëpër sektor vërehet në sektorin e bujqësisë në të cilin kishim një rritje prej 2% dhe tregtisë me shumicë dhe pakicë rritje për 1%. Ndërsa sa i përket madhësisë së biznesit, portofoli i garantuar edhe gjatë 2023, vazhdon të ketë pjesëmarrje më të madhe nga ndërmarrjet mikro. Përqendrimi i portofolit të garantuar sipas numrit të punëtorëve në segmentin e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla deri në 49 punëtorë ishte 99%.

Stimulimi i sektorëve që krijojnë vlerë të shtuar për ekonominë si dhe diversifikimi sa më i mirë mbetën një nga objektivat e FKGK-së. Prandaj, FKGK me ndihmën e donatorëve dhe partnerëve të saj edhe këtë vit ka implementuar dritare për fuqizimin e sektorëve strategjik siç ishin Dritarja për Gratë për Biznes dhe Dritarja për Startup-ët.

Si përfundim, progresi i bërë në zhvillimin e portofolit tonë të garancive këtë vit do të nënvizojë angazhimin tonë për përmirësim të vazhdueshëm të dritareve dhe përsosmëri të proceseve, duke demonstruar një pozicionon edhe më të mirë në drejtim të avancimit dhe impaktit të mëtejshëm në zhvillimin e NMVM-ve dhe të ekonomisë në përgjithësi.



# ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË GARANCIVE PËR VITIN 2023



Rreth 99% e portofolit përbëhet nga ndërmarrjet mikro dhe të vogla



NMVM-të shfrytëzuan kreditë për investime:



# SKEMAT GARANTUESE TË FKGK-SË DRITARET - ZHVILLIMI DHE RISITË

Skemat apo ndryshe si i quajmë Dritare Garantuese janë garanci për institucionet financiare për të mbuluar rrezikun për kreditë e lëshuara ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) dhe janë të dizenuara asisoi që sa më tepër t'i përshtaten karakteristikave dhe nevojave të segmenteve të tregut.

Këto garanci lëshohen vetëm për kryegjënë dhe nuk mbulojnë kamatat, shumat tjera të borxhit, apo shpenzimeve të tjera që barten nga huadhënësi. Në vijim do të paraqesim dritaret aktive të FKGK-së:

## DRITARJA STANDARDE

**Dritarja Standarde është dritare gjithë përfshirëse e FKGK-së.**

Për shkak të gjithëpërfshirjes rezulton edhe me pjesëmarrje më të madhe në portofolin e kredive të garantuara gjatë 2023.

**Dritarja standarde gjatë 2023 përkrahu 1,353 NMVM në vlerë të kredisë prej 93.86 milionë euro.**

**Veçoritë që e karakterizojnë dritaren standarde:**

- ◆ Gjithëpërfshirja, që nënkupton se kjo dritare i shërben të gjitha aktivitetet e lejuara,
- ◆ Garanton vlera më të larta të kredisë, shuma maksimale e kredisë është 3,000,000 euro (për lizing 1,000,000 euro).
- ◆ Shuma maksimale e garancisë është 500,000 euro
- ◆ Afati më i gjatë i kthimit deri 120 muaj (për lizing 84 muaj).
- ◆ Kreditë mund të shfrytëzohen për investimeve afatgjata si dhe kapital punues.
- ◆ Për shumat të larta, ofron tarifë më të ulët të kredisë
- ◆ Ofron garanci deri në 50%.



# DRITARJA AGRO

Dritarja Agro ofron garanci për institucionet e regjistruara financiare për të mbuluar rrezikun për kreditë në sektorin agro, duke përfshirë prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore.

E veçantë e kësaj dritare është se ofron garanci për biznese të regjistruara në ARBK dhe fermerët që posedojnë Numër Identifikues të Fermës. Përfshirja e gjithë zingjirit nga prodhimi e gjerë te përpunimi, përfshirja e fermerëve që posedojnë NIF, si dhe rritja e garancisë kreditore për vlera më të larta, kanë bërë që kjo dritare të tregoj një progress gjatë 2023.

**Dritarja agro gjatë 2023 përkrahu 434 fermer dhe NMVM në vlerë të kredisë prej 17.81 milionë euro.**

## Veçoritë që e karakterizojnë dritaren agro:

- ◆ Garantim i prodhimtarisë primare dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore
- ◆ Garantim i fermerëve dhe agrobizneseve vendore
- ◆ Lejim i garantimit të fermerëve me NIF
- ◆ Normë më e favorshme e garancisë, **deri në 60%** të kryegjësë së kredisë bujqësore, për garancitë deri në 50,000
- ◆ Afat maksimal i kthimit të agro kredisë së garantuar, deri 120 muaj.
- ◆ Ofron garanci deri në 50%.



DRITARJA  
AGRO

# GROW

**Dritarja e Rimëkëmbjes dhe Mundësive të Gjelbëra garanton financimet në fushën e energjisë së ripërtëritshme dhe eficiencës së energjisë. Qëllimi i kësaj dritareje është të mbështesë NMVM-të drejt qëndrueshmërisë dhe eficiencës.**

Kjo dritare e cila u lansua në qershor të 2022 e pilotuar me një IRF, në 2023 ju ofrua si mundësi edhe IRF-ve të tjera të interesuara.

Qëllimet e mbështetura të kredisë përmes kësaj dritareje mund të janë investimet në:

- ◆ Eficiencën e Energjisë (mbështjellësi i ndërtesës, pajisjet, linjat e prodhimit dhe masat e tjera të eficiencës së energjisë).
- ◆ Energjia e ripërtëritshme në shkallë të vogël (erë, diellore, biomasë ose energji gjeotermale) deri në 400 kW.

**Dritarja GROW që nga themelimi deri tani përkrahu 7 NMVM në vlerë të kredisë prej 3.9 milionë euro.**

**Veçoritë dalluese të dritares janë:**

- ◆ Ekspozim më i lartë garantues për klientin deri në një (1) milion euro.
  - Deri 500,000 euro maksimumi i garancisë.
  - NMVM mund të ketë edhe ndonjë ekspozim tjetër garantues në FKGK (totali nuk duhet të kalojë një (1) milion euro si përfitues nga garancitë e kredisë sipas FKGK-së).
- ◆ Tarifë më e ulët e garancisë.
  - Investimet e Eficiencës së Energjisë
  - Investimet e Energjisë së Ripërtëritshme
- ◆ Rigarantim nga DFC dhe Sida
- ◆ Komponenta jo financiare **e-Save** në dispozicion të stafit të IRF-ve, për të verifikuar, matur dhe vlerësuar eficiencën e energjisë dhe reduktimin e CO<sub>2</sub> nga investimi i bërë.

## Prodhoni vetë energjinë për biznesin tuaj!

**GROW** Green Recovery and Opportunity Window





# DRITARJA E EKSPORTIT

Dritarja e eksportit lehtëson qasjen në financa dhe stimulon ndërmarrjet eksportuese duke ofruar garanci me tarifa preferenciale.

Duke qenë se eksporti është një nga faktorët kryesorë që ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit, FKGK ka për qëllim që përmes kësaj dritareje të stimulojë këtë segment pavarësisht nivelit të eksporteve që një ndërmarrje mund të ketë, përmes ofrimit të garancive kreditore me tarifa preferenciale. Garancitë ofrohen për shumën **deri në 50%** të kryegjësë së kredisë.

## Veçoritë dalluese të dritares janë:

- ◆ Shuma maksimale e garancisë deri 1,000,000 euro
- ◆ Mbulueshmëri në nivel të portofolit 100%
- ◆ Normë më e favorshme e garancisë
- ◆ Rigarantim nga Sida
- ◆ Gjithëpërfshirje për të gjitha ndërmarrjet të cilat në baza të rregullta, një pjesë të shitjeve e realizojnë në tregun e jashtëm, ose ato që kanë për qëllim që me kredinë e cila është subjekt i garancisë kreditore të investojnë në resurse të cilat zgjerojnë aktivitetin për qëllime eksporti

**Dritarja e eksportit gjatë 2023 përkrahu 29 NMVM në vlerë të kredisë prej 4.7 milionë euro.**



# DRITARJA GRATË NË BIZNES

Dritarja për Gratë në Biznes lehtëson qasjen në financa për gratë ndërmarrëse si dhe ofron sesione trajnimi në fushat e menaxhimit strategjik dhe financiar të ndërmarrjes.

Ky instrument financiar është një mbështetje e cila pritet të ndikojë në sigurinë financiare, dhe fuqizimin financiar dhe të pavarur të grave. Kjo dritare ofrohet me kushte të favorshme për sa i përket riskut të kredisë. Garancitë do të ofrohen për shumën **deri në 70%** të kryegjësë së kredisë.

Përveç komponentit financiar, FK GK është duke ofruar edhe komponentin jofinanciar ose programin e asistencës teknike për gratë në biznes të cilat po mbështeten në aspektin e ngritjes së kapaciteteve (edukimi financiar dhe formalizimi), rrjetëzimit, si dhe mentorimit.


## Veçoritë dalluese të dritares janë:

- ◆ Normë më e lartë e garancisë, deri 70%
- ◆ Rigarantim nga Sida
- ◆ Komponenta jofinanciare
  - Trajnim
  - Mentorim
  - Rrjetëzim
  - Ofrimi i platformës **Business Help** (për mirëmbajtjen e shënimeve relevante për një biznes)

Kreditë e Kualifikuara që plotësojnë kriteret e mëposhtme do të jenë të pranueshme për përfitimet e Dritares për Gra në Biznes:

- ◆ NMVM duhet të jetë ose në pronësi ose në bashkëpronësi nga më së paku një grua ose të udhëhiqet nga të paktën një grua në një pozicion ekzekutiv.
- ◆ Shuma maksimale e kredisë është 50,000 euro.
- ◆ Afati maksimal i kthimit të kredisë së garantuar deri 84 muaj.
- ◆ Qëllimi i kredisë mund të jetë për investime dhe kapital punues.

**Dritarja e Gratë në Biznes gjatë 2023 përkrahu 71 NMVM në vlerë të kredisë prej 1.9 milionë euro.**



# DRITARJA START-UP

Dritarja Start-Up lehtëson qasjen në financa për ndërmarrjet e reja me produkte financiare adekuatë..

Qëllimi i kësaj dritare është që të sigurohet rritja e bizneseve të reja dhe rritja e punësimit. Garancitë do të ofrohen për shumën **deri në 80%** të kryegjësë së kredisë.

Kjo dritare u dedikohet bizneseve start-up me përvojë deri në dymbëdhjetë muaj nga regjistrimi, të angazhuara kryesisht në aktivitete/sectorë ekonomik që kërkojnë njohuri bazë. Njohuritë bazë i referohen aftësive që krijohen përmes një arsimimi, trajnimit ose përvojë pune të mëparshme. Përveç komponentit financiar, FKGK është duke ofruar edhe komponentin jo-financiar ose programin e asistencës teknike për bizneset e reja, të cilat do të mbështeten në aspektin e ngritjes së kapaciteteve (edukimi financiar dhe formalizimi), rrjetëzimit si dhe mentorimit.

## Veçoritë dalluese të dritares janë:

- ◆ Norma më e lartë e garancisë, krahasuar me të gjitha dritaret tjera, deri në 80%
- ◆ Komponenta jo-financiare
  - Trajnim
  - Mentorim
  - Rrjetëzim
  - Ofrimi i platformës **Business Help** (për mirëmbajtjen e shënimeve relevante për një biznes)

Kreditë e Kualifikuara që plotësojnë kriteret e mëposhtme do të jenë të pranueshme për përfitimet e Dritares për StartUP:

- ◆ Shuma maksimale e kredisë është 50,000 euro.
- ◆ Shuma maksimale e garancisë është 40,000 euro.
- ◆ Afati maksimal i kthimit të kredisë së garantuar deri 60 muaj.
- ◆ Qëllimi i kredisë mund të jetë për investime dhe kapital punues.

**Dritarja Startup gjatë 2023 përkrahu 32 NMVM në vlerë të kredisë prej 973 mijë euro.**




# SHTUESHMËRIA - 2023

FKGK shërben si një institucion i rëndësishëm në mbështetjen e rritjes ekonomike dhe fuqizimin e ndërmarrësisë në Kosovë. Parimi themelor i shtueshmërisë shërben si një portë e mbështetjes për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) dhe për sipërmarrësit që mund të përballen me pengesa në qasje tradicionale të kreditimit. Duke ofruar një mekanizëm garancie, fondi ka zgjeruar kreditimin për këto entitete, duke stimuluar investimet, krijuar vende të reja pune dhe zhvilluar ekonominë në përgjithësi.

Për më tepër, angazhimi proaktiv i fondit në ndërtimin e kapaciteteve dhe edukimin financiar rritë edhe më shumë shtueshmërinë duke pajisur individët dhe bizneset me mjete dhe njohuri të nevojshme për t'u zhvilluar në një mjedis konkurrues. FKGK jo vetëm që ka lehtësuar qasjen në financa, gjithashtu ka shërbyer edhe si katalizator i qendrueshmërisë ekonomike, duke konsoliduar kështu rolin e tij të padiskutueshëm në zhvillimin ekonomik të vendit.


## PJESËMARRJA E KREDIVE TË GARANTUARA NË SEKTORIN BANKAR

Në grafikun në vijim, është evidentuar se pjesëmarrja e kredive të garantuara në sektorin bankar është më e lartë tek kompanitë që marrin kredi për herë të parë. Pjesëmarrja më e lartë vërehët të jetë më e lartë është në rangun e kredive 50,000 deri në 100,000. Për vlera më të larta të kredive, pjesëmarrja e kredive të garantuara nga FKGK është më e ulët, duke arritur në 1% për kreditë deri në 1 milion euro. Kjo reflekton qëllimin e FKGK-së për të rritur vlerën në sektorin bankar duke shtuar numrin e klientëve të rinj që nuk kanë kredi të mëparshme dhe duke rritur pjesëmarrjen në kreditë deri në 100,000 euro.




## MESATARJA E MATURITETIT TË KREDISË - KOHËZGJATJE MË E LARTË E KREDIVE

Maturiteti i kredive të garantuara vazhdon të jetë më i gjatë se ai i kredive të pagantuara. Grafiku më poshtë shfaq mesataren e maturiteteve për kredi të garantuara dhe të pagantuara. Gjatë vitit 2023, mesatarja e kredive të garantuara ka qenë më shumë se 39 muaj, ndërsa kreditë e pagantuara kanë pasur një mesatare prej 32 muajsh. Ky rezultat paraqet kushtet më të favorshme të financimit për kredinë e garantuar krahasuar me atë të pagantuar.



## MBULUESHMËRIA ME KOLATERAL

Ndikimi i programit garantues gjithashtu shihet në kërkesën për kolateral. Kredive të garantuara, në krahasim me ato të pagantuara, mesatarisht u kërkohet një shkallë e ulët e kolateralit, për 71%. Te kreditë e reja të garantuara, dallimi në kërkesën për kolateral është edhe më i ndjeshëm; për kreditë e reja të garantuara, në mesatare, kërkohet një shkallë e reduktuar prej 78% e kolateralit në krahasim me kreditë e reja të pagantuara.



## PJESËMARRJA E VOLUMIT TË KREDIVE AKTIVE TË GARANTUARA NGA FKGK NË BRUTO PRODHIMIN VENDOR (BPV)

Skema e garancisë është një nga politikat më të rëndësishme për mbështetjen e NMV-ve gjatë periudhave të hendeikut të likuiditetit. Kjo politikë luan një rol kyç në vazhdimësinë funksionimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, veçanërisht gjatë krizave financiare, kur qasja në financa është e kufizuar. Pjesëmarrja e volumit të kredive aktive të garantuara nga FKGK-ja në Bruto Produktin Vendor (BPV) për vitin 2023 është 1.21%. Kjo mbështetje është thelbësore për ruajtjen e vitalitetit ekonomik dhe potencialit të rritjes së këtyre ndërmarrjeve, të cilat shpesh janë shtyllë e ekonomisë.

# MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR

Njësia për Menaxhimin e Riskut është përgjegjëse për sigurimin e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të riskut në kuadër të FKGK-së, duke kryer identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe zbutjen e risqeve. Kjo njësi realizon vlerësime të rregullta të risqeve të mbajtura nga FKGK-ja, duke shqyrtuar vazhdimisht risqet specifike të organizatës dhe tregut, si dhe zbaton masa të përshtatshme për menaxhimin e tyre. Për më tepër, Njësia për Menaxhimin e Riskut vlerëson dhe rekomandon strategji për menaxhimin e risqeve që rrjedhin nga portofoli, ndërton dhe mban sisteme dhe kontrolle efektive për të identifikuar dhe trajtuar risqet operacionale në kuadër të FKGK-së.

Njësia zhvillon dhe zbaton politika të menaxhimit të riskut, duke përfshirë ato që lidhen me riskun e garancisë kreditore dhe riskun operacional, si dhe promovon vetëdijësimin për riskun në të gjithë institucionin. Duke i plotësuar përgjegjësitë e veta, Njësia për Menaxhimin e Riskut siguron që:

- Vendimet për riskun janë në përputhje me treguesit e përcaktuar dhe proceset e kontrollit dizajnohen dhe të zbatohen në mënyrë të qëndrueshme.

- Produktet e garancisë dizajnohen për të adresuar elementët e riskut, njëkohësisht duke mbështetur në mënyrë të vazhdueshme NMVM-të (Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme).

## RISKU I GARANCISË KREDITORE

Risku kryesor i FKGK-së vjen nga roli i vet në garantimin e pjesshëm të kredive për NMVM-të nga Institucionet e Regjistruara Financiare (IRF-të). Me përgjegjësinë e deleguar te IFR-të për vlerësimin, marrjen e vendimeve dhe menaxhimin e kredive për NMVM-të, aftësia e FKGK-së për t'i menaxhuar risqet është e kufizuar. Si përgjigje ndaj këtyre sfidave thelbësore dhe për të vendosur një qasje proaktive në nivel portofoli, FKGK-ja i ka përshtatur proceset e menaxhimit të riskut dhe strukturën e vet.

Për t'i menaxhuar efektivisht risqet e garantimit, FKGK-ja zbaton procese gjithëpërfshirëse ku bëjnë pjesë masa të ndryshme. Këtu përfshihen përcaktimi i ekspozimit agregat të garancisë sipas faktorit të levës, treguesit e riskut, si dhe përcaktimi i kriterëve të qarta kualifikuese për IRF-të dhe NMVM-të.

Duke theksuar mbikëqyrjen dhe kontrollin e vazhdueshëm, strategjia e menaxhimit të riskut të FKGK-së përfshin monitorimin dhe kontrollet e rregullta në sektorin financiar, në nivel të IRF-ve, si dhe në nivelin e ekspozimit të garantuar. Për të zbutur riskun, FKGK-ja garanton në shumicën e dritareve në bazë të barabartë, zakonisht deri në 50%, me mbulim më të lartë në segmente të caktuara të tregut apo grupe që konsiderohen strategjike për FKGK-në. Gjithashtu, FKGK-ja synon zbutjen e riskut përmes skemave të ri-garancisë dhe përforsimit të përpjekjeve për diversifikimin e portofolit.

Duke e pranuar diversifikimin si një mjet të rëndësishëm për zbutjen e riskut të portofolit, FKGK-ja ka zhvilluar procese që lehtësojnë diversifikimin në nivele të ndryshme:

- Në nivel të IRF-ve, duke ndarë limitet e garantimit dhe duke përcaktuar ekspozimin maksimal të garantimit.
- Në nivel të NMVM-ve, duke përcaktuar ekspozimin maksimal të garantimit për çdo NMVM dhe palët e lidhura.
- Në nivel sektorial, duke siguruar shmangien e koncentrimin të tepërt në çdo sektor të vetëm, duke ekuilibruar ekspozimin me objektivat e FKGK-së dhe kushtet e tregut.
- Në nivel të rajoneve, duke monitoruar zhvillimin e portofolit për ta ekuilibruar me kushtet e tregut ose objektivat e FKGK-së.

## ZBATIMI I RISKUT OPERACIONAL

Gjatë vitit 2023, FKGK-ja u përkushtua në përgatitjen e politikave dhe procedurave për menaxhimin e riskut operacional, me plane për fillimin e zbatimit të tyre në vitin vijues. Kjo strategji e zbatimit është kujdesur për ta përshtatur riskun operacional me nevojat specifike dhe dinamikën operacionale të FKGK-së. Në përgjithësi, FKGK-ja e trajton riskun operacional si potencialin për humbje që lind nga proceset e brendshme (si p.sh.: personeli, sistemet) ose edhe nga faktorët e jashtëm. Ky përkufizim i gjerë përfshin kategori të ndryshme të riskut, por pa u kufizuar në mashtrimet, teknologjinë, pajtueshmërinë ligjore dhe rregullatore dhe risqet në procese.

Përt'i menaxhuar efektivisht këto risqe operacionale, FKGK-ja do të përdorë disa mjete, si:

- **Procesi i vetëvlerësimit dhe kontrollit të riskut:** Ky proces sistemik ndihmon në identifikimin, analizën dhe zbutjen e risqeve, dhe përfshin intervista me stafin e FKGK-së në vlerësimin e kontrolleve të brendshme dhe cenueshmërisë operacionale.
- **Regjistri i humbjeve operacionale:** Një bazë e të dhënave e dedikuar për regjistrimin dhe analizën e ngjarjeve operacionale, humbjeve (apo afër-humbjeve), duke i mundësuar FKGK-së të nxjerrë përfundime dhe të përmirësojë strategjitë e zbutjes së risqeve.
- **Procesi i miratimit të riskut të ri:** Ky proces zbatohet për të vlerësuar dhe miratuar procese, produkte apo instrumente të tjera te reja përpara se ato të zbatohen ose të përdoren për herë të parë, për të siguruar vlerësimin e risqeve potenciale, si dhe për ndërmarrjen e masave dhe përgatitjeve të përshtatshme për vlerësimin efektiv të atyre risqeve.
- **Treguesit kyç të riskut:** Shërbejnë si tregues për të matur potencialin e riskut në fusha të ndryshme dhe ofrojnë sinjale të paralajmërimit të hershëm që mund të sugjerojnë rritje të ekspozimit ndaj riskut, duke mundësuar kështu menaxhim proaktiv të riskut. Treguesit kyç të riskut monitorohen rregullisht çdo tre muaj, për të ndjekur trendet dhe devijimet.

Duke i përdorur këto mjetet dhe procese të menaxhimit të riskut, FKGK-ja synon të përforcojë qëndrueshmërinë kundrejt risqeve operacionale, të mbrojë institucionin dhe të sigurojë performancë të qëndrueshme në përmbushjen e misionit të vet.

## AKTIVITETET E RISKUT NË FKGK

Në vitin 2023, FKGK-ja vazhdoi të jetë proaktiv në menaxhimin e riskut, duke kryer përditësime në politikat dhe procedurat e saj. Këto përditësime kishin për qëllim përmirësimin e cilësisë së produkteve, veçanërisht duke përsosur kriteret e kualifikimit, për të inkurajuar një pjesëmarrje më të gjerë me NMVM-të dhe për të ofruar mbështetje shtesë për sektorët që janë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit.

Njësia e menaxhimit të riskut gjithashtu filloi implementimin e stres testimeve, për të vlerësuar kufijtë e tolerancës në portofolin e FKGK-së. Në përputhje me politikat dhe procedurat e brendshme, FKGK-ja shqyrtoi dhe aprovoi kërkesat për rishikimin e limiteve garantuese të IRF-ve gjatë vitit 2023, në përputhje me kufijtë e lejuar të tolerancës. Praktika e vlerësimit vjetor të IRF-ve u vazhdua, duke përdorur një qasje të thelluar për IRF-të që kanë treguar performancë më të ulët ose kanë treguar indikacione që kanë nevojë për vlerësime më të detajuara.

Institucioni vazhdoi praktikën e takimeve mujore, duke kryer analiza të hollësishme të tendencave në sektorin bankar dhe performancës së individëve të IRF-ve. Deri në fund të vitit, ekspozimi total i FKGK-së ndaj IRF-ve ishte 158.5 milionë euro, me mbulim të ofruar nga një fond me kapital që arrinte në 80.4 milionë euro. Ky kapital është i përbërë nga fondet e dhuruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, donatorët ndërkombëtarë si dhe fitimi i mbajtur i dedikuar për qëllime specifike që krijojnë besueshmëri që FKGK-ja është mjaftueshëm e kapitalizuar dhe ka aftësi të absorbojë riskun ndaj të cilët është i ekspozuar





Një rol kyç për institucionin tonë ishte përdorimi i skemës së ri garancisë të ofruar nga Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar (SIDA). Kjo skemë, së bashku me skemat tjera të ri garancisë, ndihmoi në ndarjen e riskut, rritjen e kapacitetit garantues, uljen e shpenzimeve, dhe uljen e tarifave të lidhura me kredidhëniet e garantuara.

Aktiviteti i rëndësishëm gjatë vitit 2023 ishte digjitalizimi i disa proceseve të FKGK-së. Gjatë këtij viti u digjitalizuan: Procesi i alokimit të limitit garantues; Procesi për paraqitjen e kërkesave për pagesë dhe raportimi i rikuperimeve pas pagesës së kërkesës. Ky proces ndihmoi në përmirësimin e proceseve të FKGK-së si dhe në identifikimin dhe monitorimin e risqeve që mund të dalin nga mos respektimi i standardeve dhe politikave. FKGK-ja vazhdon komunikimin e rregullt dhe të detajuar me IRF-të, gjë që bën të mundur të mbetet e informuar për çështjet që prekin aktivitetin e tij.

## NDIKIMI I FAKTORËVE TË JASHTËM NË FKGK

Edhe pse u shënuan hapa drejt rimëkëmbjes ekonomike pas pandemisë, peizazhi ekonomik në Kosovë vazhdon të përjetojë turbullira të shumta, të shkaktuara nga krizat globale të energjisë, rritja e inflacionit, dhe problemet politike në veri të vendit.

Këto paraqesin sfida të vazhdueshme për sektorin financiar.

Megjithatë, në mes të këtyre sfidave të forta, sektori financiar në Kosovë ka vazhduar të tregojë qëndrueshmëri, duke ruajtur likuiditetin dhe stabilitetin gjatë gjithë vitit 2023. Në këtë përballje me risqet dhe sfidat e pranishme, FKGK-ja ka vazhduar të mbetet i vendosur në përkushtimin e vet për të lehtësuar dhe për të avancuar aktivitetet e kredive nga IRF-të.

Duke prezantuar produkte financiare relevante për sektorë të ndryshëm, FKGK-ja synon t'i zgjerojë investimet në gjenerim të energjisë së ripërtërishme, eficiencë të energjisë, ndërmarrje të orientuara drejt eksportit, sektorin bujqësor, ndërmarrje të grave në biznes, biznese start-up, si dhe në përgjithësi t'i mbështesë NMVM-të përmes lehtësimit të qasjes në financa.


Përveç masave proaktive të zbatuara, FKGK-ja ka ndërmarrë veprime të rëndësishme dhe masa tjera të menaxhimit të riskut si pagesat e kërkesave të paraqitura nga IRF-të dhe zgjatja e afatit të kredive përmes ristrukturimeve të kredive të garantuara. Këto masa kanë ndihmuar në zbutjen e efekteve të inflacionit dhe zhvillimin e NMVM-ve.



# KUALITETI I PORTOFOLIT


Në vitin 2023, kualiteti i kredive të garantuara ka vazhduar të mbetet në nivelet e parashikuara. Bilanci garantues në datën 31 dhjetor 2023 ka qenë në vlerën prej 116.2 milionë euro. Gjatë vitit 2023, kemi vërejtur rritje në nivelin e kredive delinkuente

dhe atyre jo performuese, por kjo rritje reflekton gjendjen e përgjithshme të kualitetit të portofolit për kreditë e NMVM-ve në treg. Sipas të dhënave më të fundit, shkalla e kredive delinkuente për kreditë e garantuara ka qenë 1.60%, ndërsa shkalla e kredive jo performuese 2.83%. Gjithashtu, shkalla e kërkesave të paguara (përfshirë vitet paraprake) ka arritur në vlerën prej 2 milionë eurosh, duke kapur vlerën prej 1.73% në krahasim me bilancin e garantuar.




Në vitin 2023, numri i kërkesave për pagesë ka shënuar rritje krahasuar me vitet e mëparshme. Të gjitha kërkesat e paraqitura nga IRF-të për kreditë e kualifikuara janë vlerësuar në përputhje me marrëveshjen e garantimit dhe politikat e brendshme të FKGK-së. Vetëm gjatë vitit 2023, FKGK-ja ka paguar në total 64 kërkesa për kreditë e garantuara në vlerën prej 900 mijë eurosh,

duke kapur vlerën 0.77% në krahasim me bilancin e garantuar në nivel vjetor. Maturiteti mesatar i kredive të garantuara nga FKGK-ja është rreth 3 vjet, gjë që shfaqet edhe në amortizimin e portofolit të FKGK-së. Siç mund të shihet në tabelën në vijim, pjesa më e madhe e portofolit të FKGK-së përbëhet nga kreditë e lëshuara nga viti 2020 e tutje.



Në vitin 2023 vërehet se performanca e dritares që u krijua gjatë pakos së rimëkëmbjes ekonomike është më e dobët krahasuar me dritaret e tjera, ndërsa dritaret për Agro qëndrojnë më mirë.



## REZERVAT E PROVIZIONIMIT

FKGK-ja vijoi ndërtimin e rezervave të provizionimit sipas standardet të IFRS9, respektivisht sipas modelit të humbjeve të pritura. Rezerva për humbjet e pritura për kreditë e garantuara dhe asetet e tjera, arrin në 4.9 milionë euro, teksa në vitin paraprak ishte 3.2 milionë euro, duke shënuar rritje prej 52% krahasuar me vitin paraprak. Rezervat

totale të provizionimit të garancive në vitin 2023 ishin 3.9% në raport me bilancin e garantuar, vlerë kjo e përafërt me atë të sektorit financiar në Kosovë (3.2% sektori bankar), ndërsa mbulueshmëria e kredive jo performuese është 139%, çka dëshmon mbulueshmëri të mjaftueshme me rezerva.

### Rezervat e provizionimit për portfolion e garantuar

Gjithsej Garanci	Bilanci Garantues	Shuma e VHP	VHP %	PAR
Etapa 1	110,839,101	1,878,373	1.7%	95.3%
Etapa 2	2,121,879	628,529	29.6%	1.83%
Etapa 3	3,284,080	2,059,351	62.7%	2.83%
<b>Gjithsej</b>	<b>116,245,060</b>	<b>4,566,253</b>	<b>3.9%</b>	<b>100.0%</b>

Krahas garancive, FKGK-ja ndërtoi rezerva të provizionimit edhe për asete të tjera që përfshijnë depozitat e IRF-ve, si dhe në bono qeveritare të Republikës së Kosovës. Vlen të theksohet se modeli i humbjeve të pritura shërben si informacion shumë i mirë në lidhje me perspektivën e cilësisë së portfolit të FKGK-së, e cila përdoret edhe në modelin e llogaritjes së tarifës së garantuar.

### Rezervat e provizionimit për asetet tjera

Asete të tjera	Investime	Shuma e VHP	Provizionimi %
Etapa 1	87,336,072	339,388	0.4%
<b>Gjithsej</b>	<b>87,336,072</b>	<b>339,388</b>	<b>0.4%</b>

# STRUKTURA E KAPITALIT

Në raportin vjetor të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) për vitin 2023, shqyrtojmë ndryshimet dhe zhvillimet në strukturën e kapitalit që nga viti 2016. Kjo analizë evidenton burimet e kapitalit, përfshirë kontributet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe partnerët ndërkombëtarë, si dhe performancën e fitimit të akumuluar.

## KONTRIBUTET DHE FONDET

**Qeveria e Republikës së Kosovës:** Gjatë periudhës së raportit, Qeveria ka qenë kontribuesi kryesor, duke siguruar 58% të kapitalit të FKGK-së.

**KfW:** Si kontribues i dytë për nga madhësia, KfW ka furnizuar 30% të kapitalit.

**USAID:** Ka kontribuar me 7% të kapitalit total.

**Fitimi i Akumuluar:** Përbën 5% të kapitalit, ku është vërejtur një trend rritjeje progresive të fitimeve.

## VEPRIMTARI TË RËNDËSISHME TË VITIT 2023

**Kontribut Shtesë nga Qeveria e Kosovës:** Një injektim kapitali prej 22,631,590 milion euro u realizua në kuadër të marrëveshjes me Bankën Evropiane të Investimeve (EIB), që dëshmon angazhimin e qeverisë për të mbështetur zhvillimin e sektorit të garancive kreditore.

**Rritja e Fitimit të Akumuluar:** Fitimi i akumuluar për vitin 2023 ishte 926,061 milionë euro, reflektuese e një menaxhimi të mprehtë të fondeve dhe të ardhurave nga investimet.

FKGK nuk praktikon shpërndarjen e dividendëve. Çdo fitim rikapitalizohet, duke rritur kështu kapitalin dhe fuqizuar kapacitetin e fondit për të ofruar më shumë garanci për kredi në të ardhmen. Ky raport shërben si një pasqyrë e angazhimit të FKGK-së për të përmirësuar infrastrukturën financiare dhe të rritur aksesin në financim për bizneset në Kosovë, duke theksuar njëkohësisht rolin jetik të mbështetjes së qeverisë dhe partnerëve ndërkombëtarë.

## Zhvillimet në strukturën e kapitalit ndër vite

	Qeveria e Republikës së Kosovës	USAID	KfW	Fitimi i akumuluar	Gjithsej
<b>Kapitali 2016</b>	2,000,000 €	5,345,141 €	-	3,149 €	7,341,992 €
<b>Kapitali 2017</b>	1,000,000 €	445,780 €	7,000,000 €	179,017 €	8,624,797 €
<b>Kapitali 2018</b>	-	-	-	320,012 €	320,012 €
<b>Kapitali 2019</b>	-	-	-	484,334 €	484,334 €
<b>Kapitali 2020</b>	21,410,000 €	-	11,500,000 €	66,312 €	32,976,312 €
<b>Kapitali 2021</b>	-	-	5,600,000 €	430,202 €	5,169,798 €
<b>Kapitali 2022</b>	-	-	-	2,818,066 €	2,818,066 €
<b>Kapitali 2023</b>	22,631,590 €	-	-	926,061 €	23,557,651 €
<b>Gjithsej</b>	47,041,590 €	5,790,921 €	24,100,000 €	4,360,451 €	81,292,926 €
<b>%</b>	58%	7%	30%	5%	100%

Kapitalizimi i institucionit mbetet një prioritet kyç për fuqizimin e potencialit garantues të FKGK-së dhe për sigurimin e stabilitetit në tregun financiar. FKGK-ja zbaton një strategji të kujdesshme për përdorimin e kapitalit, bazuar në indikacionet e rrezikut në sektorin financiar, për të siguruar që kapitali i saj të jetë i mjaftueshëm për të mbështetur aktivitetet kryesore dhe për të absorbuar humbjet

e mundshme. Rritja e kapacitetit garantues ka çuar në rritje të kreditimit nga institucionet financiare, duke u ofruar atyre siguri dhe inkurajuar eksplorimin e tregjeve të reja kreditore. Kjo mbështetje ka qenë veçanërisht e rëndësishme për sektorët e pafinancuar më parë, të cilët kanë një ndikim të madh në zhvillimin e sektorit privat dhe ekonomisë së Kosovës në tërësi.

## INVESTIMET E KAPITALIT

FKGK-ja deri në fund të vitit 2023 ka arritur që ndër vite të rritë kapitalin dhe në këtë mënyrë të prezantohet si institucion stabil në tregun financiar. FKGK-ja investon një pjesë të kapitalit të vet në institucionet partnere të FKGK-së, siç edhe specifikohet në ligj dhe në këtë mënyrë gjeneron të hyra nga interesi i fituar për të mbuluar shpenzimet operative.


Të ardhurat nga investimet konsolidohen në Pasqyrën e të Ardhurave, ndërsa fitimi vjetor rinvestohet apo mbahet në FKGK, duke e rritur kapitalin, dhe nuk shpërndahet jashtë FKGK-së në asnjë formë apo mënyrë, duke i përfshirë edhe dividendët. FKGK-ja e reflekton besimin në institucionet partnere, duke lënë në menaxhim të tyre mjetet e investuara. Gjatë planifikimit për investime, FKGK-ja kujdeset që të ofrojë likuiditet në tregun financiar dhe rrjedhimisht një ndikim në rritjen e kreditimit nga ana e institucioneve financiare. FKGK-ja gjithashtu optimizon normat e kthimit nga investimet, gjithmonë duke u kujdesur që të ruajë stabilitetin në treg.

Gjatë vitit 2023, FKGK-ja ka investuar 55,536,300 euro në depozitat me afat me institucionet partnere financiare të FKGK-së, me maturitet njëvjeçar, dyvjeçar dhe trevjeçar, duke vazhduar kështu bashkëpunimin shumëvjeçar në këtë drejtim. Në vitin 2023, FKGK-ja ka investuar dhe në Letra me Vlerë të Qeverisë së Kosovës në vlerë prej 22,850,000 euro me maturitet trevjeçar dhe pesëvjeçar.


FKGK-ja investon mjetet duke ndjekur parimet e ndarjes proporcionale sipas politikës së investimeve, ku investimet tek institucionet partnere financiare përbëjnë deri në 70% të total investimeve, ndërsa investimet në Letra me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, 30%. Ndarja sipas maturitetit të investimeve ka një përbërje tjetër, ku 60% e investimeve janë me maturitet deri në njëzet e katër muaj dhe 40% e tyre me maturitet mbi njëzet e katër muaj deri në gjashtëdhjetë muaj.

Prej investimeve me maturitet deri në njëzet e katër muaj, minimum 30% e tyre duhet të jenë me maturitet deri në dymbëdhjetë muaj.


### INVESTIMET NË DEPOZITA ME AFAT DHE LETRA ME VLERË




### DEPOZITAT ME AFAT SIPAS MATURITETIT



### LETRAT ME VLERË SIPAS MATURITETIT



## KAPITALI NGA DONATORËT




# QEVERISJA MJEDISORE DHE SOCIALE

Pjesë shumë e rëndësishme për FKGK-në për çka dhe institucioni ynë mbanë përgjegjësi të plotë, është mjedisi dhe shoqëria, andaj, si e tillë kujdeset që të shmangë dhe zvogëlojë ndikimin negativ në mjedis nga investimet e mundësuar nga skema garantuese. Tanimë, me një bazë dhe procese mirë të strukturuar, ku respektohet dhe aplikohet sistemi për vlerësim duke u bazuar në parimet e qeverisjes mjedisore dhe sociale (QMS), si një kornizë që ndihmon palët e interesit të kuptojnë se si një organizatë menaxhon rreziqet dhe mundësitë rreth çështjeve të qëndrueshmërisë.

Duke zbatuar politikën e menaxhimit mjedisor dhe social sipas kërkesave të donatorëve, FKGK ka punuar me vendosmëri që të jetë më kufizues në garantimin e kredive, duke përditësuar listën e sektorëve dhe aktiviteve të përjashtuara që nuk garantohen. Edhe gjatë vitit 2023, ndikimi i FKGK-së është fokusuar në dy pjesë. Pjesa e parë ka të bëjë me ndikimin indirekt që shkaktohet në mjedis nga operacionet/veprimtaria e FKGK-së. Ndërsa, pjesa e dytë paraqet ndikimin direkt nga portofoli i garancive të FKGK-së duke u bazuar në të dhënat në dispozicion. Sipas objektivave të përcaktuara për vitin 2023, FKGK ka realizuar vizita nëpër degë të IRF-ve, ka organizuar trajnime rifreskuese lidhur me qeverisjen mjedisore dhe sociale si dhe ka zhvilluar fushatë në rrjete sociale për stafin e IRF-ve dhe dhe përdoruesit e fundit, lidhur me QMS.

## MENAXHIMI I RISKUT MJEDISOR DHE SOCIAL

FKGK-ja si institucion garantues vlerëson rreziqet që lidhen me kreditë e garantuara. Kjo përfshin vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale të operacioneve dhe identifikimin e rreziqeve të mundshme. Duke kryer vlerësime të plota të riskut, FKGK-ja vendos se cilat biznese t'i mbështesë dhe t'i drejtojë ata në zbatimin e masave zbutëse për të minimizuar ndikimet negative. Kjo lejon gjurmimin e progresit, identifikimin e fushave për përmirësim dhe sigurimin që bizneset t'ju përmbahen angazhimeve të QMS-së. Duke u bazuar në këta faktorë, FKGK-ja ka ndërtuar një sistem që vlerëson ndikimin e kredive të garantuara në aspektin mjedisor dhe social duke marrë parasysh aspektet e QMS-së gjatë procesit së vendimmarrjes, në bazë të praktikave më të mira të mundshme dhe me ndikime më të vogla mjedisore dhe sociale. Për të vlerësuar ndikimin e brendshëm të FKGK-së, janë ndërmarrë masa që të reduktohen gjurmët e karbonit duke zvogëluar konsumin e energjisë elektrike, riciklimin e mbeturinave si dhe përdorimin e taksive elektrike për operacionet. Po ashtu, FKGK-ja ka realizuar trajnime rifreskuese me IRF-të dhe IMF-të në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale të kredive të financuara dhe të garantuara nga FKGK-ja. Një tjetër komponent i rëndësishëm është rifreskimi i politikave të menaxhimit mjedisor dhe social sipas standardeve më të larta ndërkombëtare. Me këtë FKGK-ja ka kufizuar listën e sektorëve dhe aktiviteve që garantohen, duke marrë për bazë ndikimin mjedisor dhe social që mund të shkaktohet.





## ANALIZA E TREGUT

Në vitin 2023, FK GK angazhoi një kompani konsulente për të ofruar një analizë tregu për të vlerësuar përshtatshmërinë e produkteve të FK GK-së dhe sfidat e NMVM-ve në casje në financa. Studimi ofron gjetjet se qasja e pamjaftueshme në financa është barriera kryesore për rritjen e NMVM-ve në Kosovë, e ndjekur nga mungesa e fuqisë së kualifikuar punëtore. Studimi zbuloi gjithashtu se shumë biznese përdorin burime joformale financimi për shkak të qasjes së kufizuar në kredi formale që çon në kërkesë të pa plotësuar për kredi. Pavarësisht mjedisit sfidues të të bërit biznes, kjo analizë poashtu shfaq gjetjet që bizneset e anketuara kanë gatishmëri për investime. Kjo edhe më shumë thekson urgjencën e adresimit të

çështjes së qasjes në financa, duke reflektuar në një kërkesë potenciale të pa plotësuar për kredi prej 5.2 miliardë euro gjatë pesë viteve të ardhshme.


Për të adresuar këtë hendek, studimi sugjeron që të ofrohen produkte financiare të ridizajnuara duke filluar nga ulja e kërkesës për kolateral e deri te zgjerimi i gamës së produkteve financiare duke përfshirë edhe faktoringun. Ndërsa, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka mundësi të konsiderueshme të avancojë dhe zhvillojë edhe mëtej produktet financiare të ofruara për t'i shërbyer tregut të pashërbyer. Këto iniciativa synojnë të plotësojnë nevojat e bizneseve gjithnjë në rritje, duke stimuluar kështu rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

# PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTIMI I FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

FKGK nuk zhvillon kontakt të drejtpërdrejtë me kredimarrësit e kualifikuar si përfitues të fundit të garancive kreditore. FKGK sigurohet që institucionet e regjistruara financiare (IRF) i kanë të miratuara politikat dhe procedurat dhe implementojnë praktikën më të mira kundër pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit (PPP/LFT). Gjithashtu, institucioni ynë sigurohet që IRF-të, të kenë mekanizmat e kontrollit për verifikimin e klientëve të tyre para dhe gjatë krijimit të marrëdhënieve biznesore dhe kryerjes së transaksioneve, organizmin e proceseve të tjera në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Në pajtim me Politikën e FKGK-së për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, institucionet e regjistruara financiare, me rastin e raportimit të kredive nën garanci, bëjnë edhe raportimin e kredive të kualifikuara në nivel të riskut të ulët, të mesëm dhe të lartë dhe raportimin e tyre në aspekt të personave të ekspozuar politikisht. FKGK-ja monitoron rregullisht kreditë dhe kredimarrësit e kualifikuar në aspekt të pajtueshmërisë me kërkesat në fushën e PPP/LFT-së. FKGK-ja ka bërë edhe vlerësimin vjetor të institucioneve të regjistruara financiare dhe zhvillon komunikime të drejtpërdrejta me zyrtarët e pajtueshmërisë dhe të parandalimit të pastrimit të parave të IRF-ve në aspekt të vlerësimit të përmbushjes së kriterëve, kërkesave ligjore dhe standardeve në fushën e PPP/LFT.

FKGK-ja në vazhdimësi ka monitoruar zbatimin e obligimeve kontraktuese në kuadër të marrëveshjeve me institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët dhe sipas nevojës dhe kërkesës ka raportuar për çështjet që kanë të bëjnë me PPP dhe LFT. Me qëllim të ngritjes së njohurive, në vitin 2023, FKGK ka organizuar për stafin e tij një trajnim në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, i mbajtur nga përfaqësuesit e Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës.



# PJESA VI

The background features several overlapping, wavy, organic shapes in shades of teal and light blue. These shapes flow from the top right towards the bottom left, creating a sense of movement and depth. The colors are soft and muted, contributing to a clean, modern aesthetic.





VEÇORITË  
E VITIT 2023

# PARTNERITETI I FKGK-SË ME AGJENCINË SUEDEZE PËR ZHVILLIM – SIDA

Në dhjetor të vitit 2023, FKGK nënshkroi marrëveshjen e garancisë me Agjencinë Suedeze për Zhvillim – Sida. Kjo marrëveshje e rëndësishme nënvizon përkushtimin e të dy institucioneve për të mbështetur rritjen ekonomike dhe qëndrueshmërinë në Kosovë. Marrëveshja e garancisë në shumë prej 14.9 milionë euro është gati të zhblokojë investimet në vlerë prej 55 milionë euro. Objektivat e marrëveshjes përfshijnë promovimin e barazisë gjinore brenda sektorit të biznesit, nxitjen e zhvillimit të eksporteve dhe lehtësimin e tranzicionit në një ekonomi më të

gjelbër. Rritja e vazhdueshme e kapitalit të FKGK-së, e plotësuar nga skemat e rigarancisë, luan rol kyç në zgjerimin e qasjes në financa, nxitjen e konkurrencës dhe ngushtimin e hendekut financiar nëpërmjet kushteve më të favorshme. Kjo është një shtytje, por njëherazi edhe sinjal i fuqishëm për të gjitha IRF-të në Kosovë që të forcojnë partneritetin me FKGK-në. Marrëveshja e rigarancisë paraqet pikërisht një mundësi premtuese që kreditë e rigarantuara përmes skemave garantuase të FKGK-së të ofrohen me kushte më të favorshme.

## DRITARET 'GRATË NË BIZNES DHE STARTUP'

Studimet e fundit në Kosovë nxjerrin në pah një pabarazi gjinore në peizazhin e biznesit, ku gratë janë dukshëm të nën-përfaqësuara në krahasim me homologët e tyre meshkuj. Gratë në biznes përfshihen kryesisht në sektorë të karakterizuar për vlerë të ulët të shtuar dhe potencial të ulët rritjeje, e që kryesisht janë brenda segmentit mikro. Pavarësisht nga krijimtaria dhe ambiciet e tyre të qenësishme, gratë ndërmarrëse hasin pengesa gjatë rrugëtimit të tyre, duke filluar nga stereotipet shoqërore deri te qasja në financa.

Në të njëjtën kohë, edhe bizneset e reja "Start-up" si një nga segmentet më dinamike të tregut përballen me sfida të shumta gjatë krijimit dhe konkretizimit të idesë së biznesit.

Gratë ndërmarrëse dhe bizneset startup i nisin ndërmarrjet e tyre duke përdorur fonde personale, mbështetjen e familjes, apo edhe burime jo-formale, që u siguron një rritje dhe zhvillim më të kufizuar.

Për të pasur rritje, këto biznese duhet të investojnë. Natyrisht, këto investime kanë nevojë për qasje në financa më të formalizuara.

Përvojat dhe praktika na tregojnë se qasja në financa mbetet një pengesë e rëndësishme, e shoqëruar nga faktorët si: mungesa e aseteve, mungesa e pronës, historia e kufizuar e biznesit, historia e kufizuar e kredisë, strukturat joformale të biznesit dhe mungesa e njohurive bazike për financat. Këto

barriera pengojnë kolektivisht qasjen në mundësitë formale të financimit për dy kategoritë: gratë në biznes dhe startup-ët.

Duke i njohur këto sfida dhe duke u bazuar në përkushtimin tonë për të nxitur gjithëpërfshirjen, veçanërisht në mesin e grupeve të cënueshme, në vitin 2023 FKGK-ja lansoi Dritaren e Grave në Biznes dhe Dritaren për Startup-ët.

Kjo nismë që synon kapërcimin e hendekut të financimit për grupet e cënuara, ofron mundësi më të mira me një shkallë më të lartë garancie, deri në 70% për Gratë në Biznes dhe deri në 80% për Startup-ët.

Në këtë mënyrë, FKGK merr përsipër deri 80% të rrezikut të kredisë, duke lehtësuar kështu barrën e institucioneve financiare partnere.

Me këtë iniciativë, duke marrë përsipër një pjesë më të madhe të rrezikut të kredisë dhe duke ofruar përfitime shtesë siç janë tarifatat më të ulëta të garancisë, synojmë që bankat të zgjerojnë më tej kufijtë e tyre të kredidhënies për këto dy grupe të targetuara. Kjo u jep një mundësi IRF-ve të reflektojnë për kushtet e kreditimit, pra duke filluar nga kërkesat e relaksuara për kreditim si dhe në normat e interesit. Kështu, bizneseve nga këto grupe të synuara u mundësohet të investojnë në ndërmarrjet e tyre dhe të përfshihen në aktivitete që kontribuojnë në shtimin e vlerës në ekonomi.

# KOMPONENTA JO FINANCIARE

Ndryshe nga operacionet e mëparshme, FKGK, përveç komponentës së garancisë kreditore, në kuadër të Dritares për Gratë në Biznes dhe Dritares për Startup-et filloi me ofrimin e mundësisë për avancimin e njohurive të këtyre bizneseve në menaxhim, financa dhe fusha të tjera për të përmirësuar më tej operacionet e tyre.

Për më tepër, komponenta jofinanciare përfshin ngritjen e kapaciteteve, rrjetëzimin dhe mentorimin.

Përmes kësaj komponente, të cilën e zhvilluam vitin e kaluar, u fokusuam në trajnime për avancimin e njohurive financiare, duke theksuar rëndësinë e formalizimit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për mundësitë e financimit, burimet dhe format e financimit, çfarë duhet të dinë kur aplikojnë për kredi si dhe institucionet financiare aktive.

Për temën e fundit, ne ftuam bankat të zhvillojnë këtë pjesë të trajnimit në mënyrë që pjesëmarrësit të kenë një informacion të drejtpërdrejtë nga huadhënësit, në mënyrë që të kuptojnë se krahas mbështetjes së FKGK-së tani nuk është e vështirë të marrësh një kredi, por duhet të kesh informacion dhe njohuri të duhura për biznesin që e udhëheq.

Përveç trajnimeve, FKGK ka ofruar mentorim dhe "Business Help", një platformë e thjeshtë për të mbështetur NMVM-të përkatëse në kontabilitetin menaxherial, duke ofruar më shumë njohuri për mirëmbajtjen e të hyrave, menaxhimin e mallrave, investimet e bëra dhe planifikimin e biznesit. Në fazën fillestare kemi organizuar përafërsisht 35 grupe në pothuajse të gjitha komunitet e Kosovës, ku 250 gra në biznes si dhe 50 startup-e morën pjesë në këto trajnime. Ajo që ishte mbresëlënëse është se në këto trajnime jemi takuar çdo ditë me gra të motivuara, me ide shumë të mira dhe me vullnet të pastër për bashkëpunim me njëra-tjetrën. Kjo na ka bërë tutje të vullnetshëm që si institucion të vazhdojmë me ofrimin e kësaj komponente për ta avancuar tutje me tema të reja si marketingu digjital, shitjet elektronike si dhe shkathtësitë negociuese.

Një përkrahje e tillë e grave ndërmarrëse dhe startup-eve mendojmë që do t'i shtyjë të investojnë në bizneset e tyre dhe të zgjerojnë mundësitë për depërtim në tregjet lokale dhe rajonale. Efekti do të jetë edhe më i madh, pasi një mbështetje e tillë do të ndikonte në sigurinë financiare, si dhe krahas edukimit financiar do të kemi fuqizimin financiar dhe të pavarur të grave dhe startup-eve.

## DEKLARATAT E PJESËMARRËSVE NË SESIONET TRAJNUESE

"Nuk mund të shpreh mjaftueshëm mirënjohjen time, për mundësinë e dhënë të jam pjesë e trajnimit të organizuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore dhe përkrahur nga Banka Botërore.

Përmbajtja e trajnimit, rrjetëzimi dhe mentorimi janë të rëndësishme në rritjen e biznesit tim. Kjo iniciativë dëshmon që kur gratë fuqizohen mund të arrijnë gjëra të jashtëzakonshme."

**Igbalje Tahiri - Pronare**  
NETA Gift Shop - Ferizaj

Si një ndërmarrës, pjesëmarrja në trajnimin "Avancimi i njohurive financiare" më mundësoi të kuptuarit e qasjes ndaj financimit, më shpjegoi shumë bukur për pasqyrat financiare; bilancin e gjendjes dhe shumë tema tjera.

Tani kam një perspektivë shumë të qartë në raport me mënyrën e menaxhimit të biznesit dhe operimet ditore nga aspekti financiar.

**Genc Rashiti – Pronar**  
Edu Courses – Podujevë

Pjesëmarrja ime në trajnimin "Avancimi i njohurive financiare" organizuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, më mundësoi të kuptuarit e qasjes ndaj financave si dhe më ka zgjeruar horizontet kur bëhet fjalë për mësimet lidhur me format e bankimit. Gjithashtu, mësimet për pasqyrat financiare, bilancin e gjendjes dhe shumë tema tjera, më dhanë krejtësisht një perspektivë tjetër në raport me mënyrën e menaxhimit të biznesit dhe operimeve ditore nga aspekti financiar.

**Ilirjeta Morina - Pronare**  
VIA CREATIVE- Prizren

Programi i trajnimit ofruar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ishte jashtëzakonisht i vlefshëm për biznesin tim. Njohuritë e fituara, sidomos platforma "Business Help" do të më ndihmojnë që ta përmirësoj pjesën e operimeve ditore, të rris bazën e klientëve.

Prandaj, unë e rekomandoj shumë këtë program për të gjitha gratë në biznes.

**Diellza Zeka – Pronare**  
Ozon Space – Prishtinë

Trajnimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore bëri një ndryshim në qasjen time ndaj financave, si një startup në teknologji.

Më hapi një dritare të re për njohuritë lidhur me financa. Gjithashtu, temat e shtjelluara më kanë pajisur me njohuri të reja lidhur me kompleksitetin e botës së biznesit."

**Rita Mustafa – Pronare**  
ICODIK – Prishtinë

Duke qenë një sipërmarrëse në fushën e fizioterapisë, pjesëmarrja në trajnimin "Avancimi i njohurive financiare", organizuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore dhe mbështetur nga Banka Botërore, ishte moment shumë i dobishëm në rrugëtimin tim profesional. Ky program ishte udhëzues për mua, duke i shndërruar konceptet e ndërlikuara financiare në koncepte të thjeshta e të kuptueshme, që do të mund ti aplikoj në përditshmërinë e punëve si sipërmarrëse. Gjithashtu, shkëmbimi i përvojave me anëtarët e grupit ishte i dobishëm, duke na frymëzuar secilin nga ne pjesëmarrëset, që të vazhdojmë rritjen dhe profesionalizimin e bizneseve tona.

**Filloreta Salihu Zejnullahu – Pronare**  
Fizioterapia & Baby Spa EKA - Lipjan

# MBYLLJA E PROJEKTIT TË BANKËS BOTËRORE PËR FUQIZIMIN E SEKTORIT FINANCIAR

Projekti i Bankës Botërore për Fuqizimin e Sektorit Financiar (FSSP) është projektuar për të lehtësuar qasjen në financa për sektorin e NMVM-ve në Kosovë përmes FKGK-së. Projekti mori mbështetje dhe u shpejtua si përgjigje ndaj pasojave ekonomike të pandemisë së Covid-19. Kjo mbështetje financiare u koordinua në bashkëpunim me Ministrinë e Financave (MoF) dhe Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), duke rezultuar me nënshkrimin e Marrëveshjes për Ndihmë mes Ministrisë së Financave dhe Fondit Kosovar për Garanci Kreditore më 17 shtator 2020. Rritja e kapitalit në vlerë prej 21.4 milionë euro ishte një injeksion i kapitalit për FKGK-në, i cili u realizua me sukses në dhjetor 2020.

Kjo shpërndarje përbënte një element kyç të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE), e cila kishte si objektiv kryesor sektorin privat, duke përfshirë sektorë të ndryshëm si Bujqësia, Gratë në Biznes, Tregtia, Prodhimi, Shërbimi dhe Startup-et.

Për të mbështetur qasjen në financa në një kohë pandemie për sektorët dhe segmentet e lartëpërmendura, FKGK operoi përmes dritareve të specializuara të përshtatura për të ndihmuar segmentet më të prekura të shoqërisë, duke përfshirë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MSME) në sektorin e prodhimit, gratë ndërmarrëse dhe startup-ët.

Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE) e FKGK-së është përgatitur me kujdes për të ndarë riskun me institucionet financiare, duke lehtësuar kështu huadhënien për NMVM-të me kushte më të lehtësuara, pavarësisht kolateralit të tyre të kufizuar dhe historisë së kredisë.

Gjithashtu, përpos rritjes së kapitalit, FSSP mbështeti FKGK-në me programin e Asistencës Teknike, duke përfshirë rekrutimin e suksesshëm të ekspertëve të çështjeve ligjore, të prokurimit, të aspekteve mjedisore dhe sociale, të monitorimit dhe vlerësimit, menaxhimit financiar si dhe specialistë për marrëdhënie me publikun dhe komunikim.

Kjo asistencë teknike mbështeti FKGK-në dhe disa nga IRF-të në ndërtimin dhe implementimin e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social për të siguruar që aktiviteti i kredidhënies, por edhe skemat e saj garantuese, të jenë në përputhje me procedurat dhe standardet mjedisore dhe sociale.

Si përgjigje ndaj kërkesës së lartë për kredi të garantuara, iniciativa PRE-së ka arritur sukses të madh pas përfundimit në fund të vitit 2021. Vlera kumulative e kredive të aprovuara në kuadër të PRE-së, të mbështetura nga fondet e Bankës Botërore përmes këtij projekti ishte 84.67 milionë euro kredi të lëshuara nga IRF-të, duke financuar 1,370 NMVM për 1,573 kredi. Në mënyrë signifikative, përqindja e garancive të dhëna për NMVM-të e drejtuara nga gratë arriti në 13 për qind të shumës totale të kredive të garantuara dhe 15 për qind të numrit të NMVM-ve.

Pas përfundimit të programit të PRE-së, FKGK në bashkëpunim me Bankën Botërore zhvilloi iniciativa të reja duke synuar sektorët e cenueshëm si gratë në biznes, startup-et, bizneset që kanë synim eksportin dhe financimin e projekteve të gjelbra. Këto dritare të reja u lansuan në 2022 dhe 2023.

Vlen të përmendet se për të përmirësuar efektshmërinë e skemave garantuese, ekipi i Bankës Botërore në bashkëpunim me FKGK-në ka bërë një vlerësim të ndikimit të skemave të FKGK-së. Rezultatet nga ky vlerësim sugjerojnë se bizneset që janë garantuar nga FKGK patën një rritje të qarkullimit prej 10% në krahasim me ato që nuk ishin garantuar. Rezultatet gjithashtu sugjerojnë se firmat që përfituan nga FKGK u bënë më produktive për 5.8% dhe zgjeruan punësimin për 2.8% më shumë se ato që nuk ishin garantuar. Po ashtu, firmat që përfituan nga FKGK kishin gati 5% më pak gjasa të ndërprejnë operacionet e tyre. Projekti i BB-së për Fuqizimin e Sektorit Financiar përfundoi më 31 dhjetor 2023, duke lënë pas një praktikë të mirë të Qeverisjes Mjedisorë dhe Sociale, të prokurimit, si dhe një institucion të mirë kapitalizuar dhe të menaxhuar mire financiarisht.

# PROJEKTI EIB

## Implementimi i Marrëveshjes me EIB

Implementimi i Marrëveshjes mes EIB dhe FKGK gjatë 2023 siguroi një implementim të mirëfilltë të marrëveshjes me Bankën Evropiane për Investime (EIB), të nënshkruar më 28 qershor 2021 ndërmjet EIB dhe Ministrisë së Financave të Kosovës në vlerë prej 40 milionë euro.

Kjo marrëveshje siguroi rritje të kapitalit për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, i cili përmes skemave garantuese lehtësoi qasjen në financa për bizneset mikro, të vogla dhe të mesme. Gjatë vitit 2023, krahas kapitalit të EIB, FKGK ndërmjetësoi një kredidhënie prej 61 milionë euro për 834 NMVM, shpërndarë në 924 kredi.

### Shuma totale e kredive të miratuara përmes Projektit FSSP

**121.3**  
milionë euro

garancitë e dhëna për NMVM-të pa e menaxhuara nga gratë

**2,279**  
kredi të garantuara

**18%**

**25%**

për

**1,953**  
NMVM

18% në numër  
16% në shumë

garancitë e dhëna për NMVM pa histori kreditore

**1,538**  
zyrtarë

Numri i zyrtarëve të trajnuar të IRF-ve

# PJESA VII

The image features a minimalist design with several overlapping, wavy, organic shapes in shades of teal and light blue. The shapes are layered, creating a sense of depth and movement. The top left corner contains the text 'PJESA VII' in a clean, sans-serif font. The overall aesthetic is modern and artistic.



**AKTIVITETET  
GJATË VITIT 2023**

# AKTIVITETET E FKGGK-së

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, edhe gjatë vitit 2023 vazhdoi aktivitetet e ndryshme siç janë sesionet informuese për stafin e IRF-ve lidhur me të gjitha skemat garantuese dhe dritaret e reja. Gjithashtu, mbajti ligjerata në institucione të arsimit të lartë, ishte pjesë e shumë forumeve që kanë temë ekonominë e financimin, ishte pjesë e promovimit të dritareve në media dhe emisione të ndryshme që i kemi listuar në vijim.

**Shkurt 2023** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore pas lansimit të Dritares Standarde dhe dritares Agro, inicoi ciklin e ri të sesioneve orientuese të disejuara për stafin e institucioneve të regjistruara financiare. Gjatë këtij muaji u përmbyll cikli i sesioneve orientuese lidhur me veçoritë e DRITARES AGRO dhe Sistemit të Menaxhimit Mjedisor e Social me Institucionet Mikrofinanciare partnere.

**Shkurt 2023** – Vazhduan sesionet informuese me biznese përmes shoqatave të ndryshme si shoqata e përpunimit të drurit, procesimit të ushqimit, sektorit të teknologjisë informative, Odë Amerikane, Oda Ekonomike e Kosovës, Klubin e prodhuesve, etj. Përmbytja e sesioneve ishte e lidhur me veçoritë e dritares së eksportit. Sesionet u mbajtën në bashkëpunim me Usaid Kosovo Compete Activity.



**Shkurt 2023** – FKGGK u takua me Bordin e Drejtorëve të Shoqatës së Bankave të Kosovës, për të diskutuar sfidat përgjegjësitë dhe mënyrën e bashkëpunimit, Në këtë takim FKGGK prezantoi zhvillimet e fundit si dhe mundësitë e reja që do të rrisin kreditimin për sektorë me prioritet. Ndër të tjerash u diskutua se si sektori bankar dhe FKGGK mund të bashkëpunojnë në mënyrë që të lehtësojnë qasjen në financa të grupeve të caktuara të ekonomisë dhe shoqërisë ku do të mund të përfitojnë.





**Mars 2023** – FKGK mbajti punëtorinë për stafin e institucioneve të regjistruara financiare me titull “Punëtorja për Raportim”. Me më shumë se 20 pjesëmarrës të pranishëm u diskutua lidhur me ndikimin e raportimit nga palët garantuese dhe proceset e reja të dixhitalizimit.



**Mars - Prill 2023** – FKGK filloi ciklin e ligjeratave me titull “Roli dhe rëndësia e skemave garantuese” në institucione të arsimit të lartë, me ç’rast gjatë 2023 mbajti ligjeratë në RIT, Universum, UBT, Univeristetin e Pejës, Universitetin e bujqësisë dhe Riinvest.



**Prill 2023** – Stafi i FKGK-së së bashku me përfaqësues të Komunës së Obliqit, mbollën 14 fidane ne oborrin e QKMF dhe Shoqatës së pensionistëve. Aktivitet që është bërë traditë në FKGK-së me rastin e përvjetorëve.



JAVA E FONDIT - PËRVJETORI 7të

**Prill 2023** – FKGK me rastin e shtatë vjetorit të themelimit lansoi dy skema reja garantuese “Dritarja Gratë në biznes” dhe “Dritarja Startup”. Në ceremoninë e lansimit u nënshkruan edhe marrëveshjet me IRF-të lidhur me këto dy skema të reja garantuese.



**Prill – Shtator 2023** – FKGK pas lansimit të dy dritareve të reja “Gratë në biznes” dhe “Startup” filloi cilkin e sesioneve orientuiese për stafin e IRF-ve. Në këto sesione u paraqitën veçoritë dhe specifikat e këtyre dy dritareve të reja.



**Qershor 2023** – FKGK pjesë e samitit ESG që u organizua me rastin e 20 vjetorit të Raiffeisen Bank. FKGK ishte pjesë e panelit të diskutimit me fokus në temën “Tranzicioni në ekonominë e gjelbër”.



**Qershor 2023** – Përfaqësuesit e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore z. Kreshnik Kurtishi, Anëtar i pavarur i bordit dhe Alban Kastrati, Menaxher i lartë i riskut, ishin pjesëmarrës në takimin vjetor 2023 të Shoqatës Evropiane të Institucioneve Garantuese që u mbajt në Athinë.



**Qershor 2023** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore vazhdoi ciklin e sesioneve orientuese të disajnuara për stafin e institucioneve të regjistruara financiare. U mbajt një sesion me stafin e Bankës Kombëtare Tregtare lidhur me veçoritë e skemave garantuese që ofron FKGK: Dritaren Standarde; Dritaren e Eksportit; Dritaren Gratë në biznes dhe Dritaren StartUp.



**Qershor 2023** – FKGK filloi ciklin e trajnimeve për stafin e institucioneve të regjistruara financiare (IRF) për dritaren GROW që u dedikohet bizneseve që investojnë në energji të ripërtëritshme (ER) dhe efikasitet të energjisë (EE). Qëllimi kryesor i FKGK-së për organizimin e këtyre trajnimeve është që stafi i institucioneve të regjistruara financiare të përfitojnë sa më shumë njohuri lidhur me veçoritë kyçe të kësaj dritareje, si dhe të zgjerojnë kapacitetet dhe njohuritë për kriteret kualifikuese për investime në ER dhe EE. FKGK gjatë trajnimeve, përmes kompanisë konsulente MACS, prezanton edhe aplikacionin inovativ “eSAVE” si një instrument llogaritës, monitorues dhe raportues për skemën garantuese të FKGK-së. Ky aplikacion do të ndihmojë të gjitha IRF-të për të menaxhuar më lehtë portofolin e kredive të bizneseve që kanë fokus energjinë e ripërtëritshme dhe efikasitetin e energjisë.



**Korrik 2023** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore u prezantua në punëtorinë “Zhvillimi Ekonomik Rural i Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës (SIRED)” organizuar nga Melita & Partners si implementuese e këtij projekti. z. Kastriot Këpuska prezantoi FKGK-në dhe foli gjerësisht për “Rolin e FKGK-së në lehtësimin e qasjes në financa me theks në sektorin e bujqësisë”.



**Gusht 2023** – FKGK nënshkruan marrëveshje me Universum International College për angazhimin e studentëve në punë praktike. Programi i praktikës është zhvilluar për t’iu mundësuar studentëve një përvojë profesionale të të mësuarit përtej teorisë, si dhe një mundësi që praktikantët të mësojnë më gjerësisht për punën dhe veprimtarinë e FKGK-së.



**Shtator 2023** – FKGK u përfaqësua nga z. Kastriot Këpuska në sesionin trajnues operacional për agrokulturë, të organizuar nga AECM - Shoqata Evropiane e Institucioneve Garantuese.



**Shtator 2023** – FKGK në përputhje me Ligjin mbi Themelimin e FKGK-së, kanë zgjedhur Znj. Anila Statovci Demaj dhe Z. Agan Azemi anëtarë të rinj të pavarur të Bordit të Drejtorëve. Në mbledhjen e rregullt të Bordit të Drejtorëve, të mbajtur të me datë 22 shtator 2023, me vendim unanim të të gjithë anëtarëve të Bordit të FKGK-së, z. Agan Azemi u emërua Kryesues i Bordit të Drejtorëve në FKGK.



**Tetor 2023** – FKGK pjesë e panelit “Mundësitë dhe rrjedha e financimit të qendrueshëm” përfaqësuar nga z. Besnik Berisha drejtor menaxhues i FKGK-së. Ky panel diskutimi u mbajt në kuadër të Forumit të Financave të Qëndrueshme, një ngjarje e rëndësishme ekonomike. Këtë forum e kanë organizuar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK), Rrjeti për Bankim dhe Financim të Qëndrueshëm (SBFN) dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare-IFC (anëtar i Grupit të Bankës Botërore) në partneritet me Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO).



**Tetor 2023** – FKGK pjesë e panelit në ngjarjen e organizuar nga NLB BANK lidhur me parimet ESG, me titull “Mundësitë dhe sfidat për biznese në integrimin e parimeve ESG”.



**Tetor – Dhjetor 2023** – FKGK nënshkruajn marrëveshjen me IRF-të për skemën garantuese –Dritaren GROW.



**Nëntor 2023** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore sot ishte prezent në “Forumit e Sektorit të Ushqimit 2023 - Lidhja e Ofertës me Kërkesën”. Gjithashtu, FKGK ishte pjesë e panelit diskutues “Produkte financiare të përshtatura për bujqësinë dhe industrinë e përpunimit të ushqimit”, përfaqësuar nga z. Kastriot Këpuska - Menaxher i projektit në FKGK.



**Nëntor 2023** – FKGK ishte pjesë e panelit të diskutimit “Qasja në Financa për Bizneset e Grave” organizuar nga banka TEB në kuadër të javës Globale të Ndërmarrësisë– “Global Entrepreneurship Week Kosovo”.



**Nëntor 2023** – FKGK – pjesë e konventës së përpunuesve të drurit me ç’rast z. Besnik Berisha, Drejtor Menaxhues i FKGK-së, prezantoi informata rreth dritares së financimit të eksportit të produkteve të drurit, skemë e rëndësishme për ekonominë e Kosovës.



**Dhjetor 2023** – Nënshkruhet marrëveshja e garancisë në mes Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar – Sida dhe Fondit Kosovar për Garanci Kreditore – FKGK.



**Dhjetor 2023** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, në kuadër të aktiviteteve të rregullta, mbajti ligjëratën e titulluar “Roli dhe rëndësia e skemave garantuese” me theks të veçantë në skemat garantuese për fermerë dhe agrobiznese. Kjo ligjeratë u mbajt në dy institucione arsimore, UBT (Universitetin për Biznes dhe Teknologji) dhe drejtimin e Agronomisë pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.



**Dhjetor 2023** – Projekti USAID Kosovo CompeteActivity bashkë me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), mbajtën tryezën me titull ‘Vlerësimi i instrumentit të mundshëm të ndarjes së rrezikut për Faktoring’. FKGK përfaqësuar nga z. Besnik Berisha, Drejtor Menaxhues, dhe z. Alban Kastrati, Menaxher i Lartë i Riskut, folën për perspektivat e përfshirjes së produkteve të Faktoringut në strukturën e mundshme të ndarjes së rrezikut. Pjesëmarrëse në këtë tryezë ishin Institucionet financiare të regjistruara, shoqatat sektoriale dhe afariste, NVM-të nga sektori i përpunimit të drurit dhe ushqimit, kompanitë e sigurimeve dhe përfaqësuesit institucional.



# FUSHATAT E FKGK-së NË 2023

Përveç aktiviteteve të ndryshme ku FKGK ishte aktive dhe e angazhuar për ta prezantuar institucionin dhe skemat garantuese, si dhe komunikimeve për skemat garantuese, me iniciativë të FKGK-së u organizuan edhe komunikime të përbashkëta me IRF-të, në veçanti për dritaren gratë në biznes dhe startup. Komunikimi i përbashkët me IRF-të për dritaret e FKGK-së u implementua përmes web faqeve dhe mediave sociale zyrtare të të dyja palëve.

**Janar - Shkurt 2023** – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore vazhdoi implementimin e Dritares Standarde përmes kapitalit nga Banka Evropiane për Investime (EIB) sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet EIB dhe Ministrisë së Financave të Kosovës. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore vazhdoi implementimin e dritares së eksportit me ç'rast promovoi këtë dritare përmes videos, broshurave digjitale duke shpjeguar veçoritë e kësaj dritare.

**Maj - Shtator 2023** – Fushatat e përbashkëta me IRF-të për dy skema garantuese: "Dritarja gratë në biznes" dhe "Dritarja Startup". Pas lansimit të dy skemave të reja garantuese "Dritarja Gratë në Biznes" dhe "Dritarja StartUp" të gjitha bankat që kanë nënshkruar marrëveshjen me FKGK për këto dy skema, bashku me FKGK-në lansuan fushatat për këto dy dritare, që ishin fushata online në media sociale si dhe web faqet zyrtare të IRF-ve.



**Korrik 2023** – FKGK lanson fushatën online për Sistemi i Menxhimit Mjedisor e Social në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore. Gjatë kësaj fushate u publikua politika mjedisore e FKGK-së; Rregullat e SMMS; Menaxhimi i Riskut Mjedisor; Praktikat më të mira të SMMS, etj.

**Shtator - Dhjetor 2023** – FKGK promovoi dritaren GROW së bashku me IRF-të që nënshkruan marrëveshjen për këtë dritare. FKGK lansoi videon e imazhit të institucionit si dhe videot e të gjitha dritareve garantuese.

# STORIET E SUKSESIT

## BLETARIA BLENARDI

### Zgjojet e bletëve në fshatin piktoresk

Javën e kaluar udhëtuam për në fshatin piktoresk Rubofc të komunës së Lipjanit për të vizituar kultivuesin e pasionuar të bletëve, Bekim Bajqinca, pronar i kompanisë "Bletaria Blenardi". Nga dashuria dhe respekti i thellë për natyrën, Bekimi vendosi ta kthente hobin e tij në një biznes të suksesshëm, me një organizim, rregullsi dhe përkushtim të duhur. Me një vizion në mendje, ai vendosi ta vazhdonte traditën familjare për bletari që, jo vetëm do të kontribuonte në ekonominë lokale, por do të promovonte edhe ruajtjen e mjedisit.

Bekimi filloi që të merrej me bletari qysh në vitin 1992. Në atë kohë, fillimisht xhaxhai i tij kishte filluar të merrej me bletë, i cili ia dhuroi Bekimit katër kosheret që posedonte.

Këtë hobi e shndërroi në biznes, por më tepër në një pasion të vërtetë. Ai e rriti numrin e koshereve në 700 sosh. Duke ushqyer me kujdes gjatë sezonit veror numër shumë të madh bletësh, Bekimi u ka kushtuar orë të panumërta dedikimi e pune atyre, dhe kjo u shpagua me rezultatin që arriti: të prodhojë përveç mjaltës me cilësi të jashtëzakonshme edhe produkte të tjera të bletëve, si: poleni, propolisi, qumështi i bletës e të tjera.

Kredia e garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore u shfrytëzua për blerjen e koshereve të reja, 500 sosh, si rezervë për përgatitjet për dimër, ashtu që pranvera e ardhshme ta gjejë bletarinë "Blenardi" të përgatitur për sezonin e radhës.

Në fshatin Rubofc dhe përreth, të gjithë kanë dëgjuar për mjaltin e mrekullueshëm që kultivon Bekimi në plantacionin e vet. Nuancat unike të luleve, që i atribuohen diversitetit të pasur të luleve në gjenden në atë territor, bëri që mjaltin ta kërkojnë jo vetëm klientët vendas, por edhe jashtë vendit, entuziastë të mjaltit të cilësor. Angazhimi i Bekimit padyshim që është njëri ndër faktorët kryesorë në suksesin e tij. I angazhuar vetëm, ai kujdeset për të gjitha kosheret që zotëron.

Sot, biznesi i bletarisë është një shembull i ndritshëm, se si një përpjekje e vogël, e nxitur nga pasioni dhe dëshira për të bërë një ndryshim, mund të lulëzojë në një histori të jashtëzakonshme suksesi. Përkushtimi i tij për mirëqenien e bletëve, fokusi i tij në praktikën e qëndrueshme jo vetëm që kanë krijuar një sipërmarrje të lulëzuar, por gjithashtu kanë nxitur një ndjenjë harmonie midis njerëzve dhe natyrës në fshatin e mrekullueshëm Rubofc.





## MY TAXI

### Një biznes pionier për të ardhmen e transportit të qëndrueshëm

Në qytetin e Mitrovicës, me plot zhurmë, një shërbim inovativ i një kompanie shërbimesh të transportit i quajtur "My Taxi" ka revolucionarizuar industrinë e transportit në këtë qytet. I themeluar në dhjetor të vitit 2021, nga një grup sipërmarrësish vizionarë që synonin të krijonin një të ardhme më të gjelbër dhe më të qëndrueshme duke investuar në vetura elektrike, solli një risi në qytet.

Duke e filluar biznesin me vetura me lëndë djegëse si trend konvencional, ata bënë një hap para duke investuar në makina elektrike. Kjo lëvizje vizionare u bë e mundur përmes kredisë së garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, institucion që është i përkushtuar të mbështesë iniciativat miqësore me mjedisin.

Dy bashkëpronarët, Mirsad Selmani dhe Driton Berisha, të rinj plot energji për punë, blenë tre vetura elektrike të tipit MG4, duke inicuar kështu një trend inovativ. Këto vetura, po tregohen më shumë se thjesht një zgjedhje miqësore me mjedisin; me kosto të ulët në afat të gjatë, duke i kursyer kompanisë shuma të konsiderueshme në shpenzimet e karburantit dhe të mirëmbajtjes.

Udhëtimet e tyre të qeta u sigurojnë pasagjerëve një përvojë të këndshme dhe të qetë udhëtimiti. Edhe pse të ri në treg, flota me vetura elektrike u bë atraksion për qytetarët të cilët pa hamendje filluan ta përdorin transportin e ri. Logoja e gjelbër tërheqëse e "My Taxi" gradualisht po bëhet një simbol i përparimit, qëndrueshmërisë në të gjithë qytetin. Për një periudhë të shkurtër kohore, veturat elektrike u bënë shumë të kërkuara, të rezervuara vazhdimisht nga vendasit dhe turistët të ndërgjegjshëm për mjedisin. Kërkesa dhe suksesi fillestar, u dha pronarëve besimin për t'u zgjeruar më tej.

Të nxitur nga kjo, ata janë të vendosur që ta zgjerojnë flotën e tyre me vetura elektrike dhe planifikojnë që deri në fund të këtij viti ti shtojnë edhe dhjetë vetura elektrike të reja. "My Taxi" me rreth 25 punëtorë numri i të cilëve shtohet gjatë sezonit të ngjeshur, kanë krijuar mundësi punësimi dhe po kontribuojnë në ekonominë lokale. Dhjetë makinat e reja elektrike që planifikojnë ti vënë në qarkullim, do të shënojnë një tjetër moment dhe kthesë për shërbimin e taksive. Edhe pse filluan me numër modest veturash, ndikimi i "My Taxi" në mjedis është i pamohueshëm.

Veturat elektrike reduktuan ndjeshëm emetimet e karbonit me 132 kg/km, duke krijuar një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm për banorët e qytetit të Mitrovicës. Suksesi fillestar, do të jetë frymëzim për bizneset tjera në industrinë e transportit, që ti konsiderojnë alternativat miqësore për mjedisin, duke shkaktuar një efekt domino pozitiv në komunitet.

"My Taxi" është një shembull shumë i mirë sesi një biznes mund të jetë fitimprurës dhe i përgjegjshëm ndaj mjedisit. Dita ditës e vërtetojnë se qëndrueshmëria dhe përfitimi shkojnë paralelisht, duke vendosur një pikë referimi për të tjerët, që do të duhej ta ndjekin. Me synimet e tyre të rritjes dhe zgjerimit të vazhdueshëm, "My Taxi" parashikon një të ardhme ku transporti i pastër bëhet normë, duke e shndërruar qytetin e tyre në një vend më të gjelbër, më të qetë dhe më të shëndetshëm për të gjithë.



## JONI SH

### Një ndërmarrje me vision

Në zemër të fshatit Ballofc të Podujevës, do ta shpalosim një storje suksesi për kompaninë JONI SH Sh.p.k. të themeluar në vitin 2016 nga Alban Shabani, një i ri me shpirt ndërmarrës dhe me vizion të qartë.

JONI SH Sh.p.k. filloi një rrugëtim që do ta transformonte jo vetëm fatin e themeluesit por edhe të fermerëve dhe të punësuarve të panumërt që u bënë pjesë e këtij rrëfimi frymëzues.

Rrugëtimi i JONI SH filloi me Albanin, një vizionar i ri me vendosmërinë për të krijuar diçka të jashtëzakonshme. Me shumë pasion për bujqësinë dhe me besim të palëkundur në vizionin e tij, ai filloi me mbjelljen e frutave në tokën e trashëguar nga prindërit. Këtë biznes e filloi i vetëm, por shumë shpejt u shndërrua në kompani me rritje në vazhdimësi.

Në vitin 2020, kjo kompani u operacionalizua edhe me përkrahjen nga donatorë dhe përmes kredive nga bankat e ndryshme, dhe këto të fundit ishin të garantuara nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë dhe u shfrytëzuan për kapital punues, biznesi zgjeroi horizontet, jo vetëm për nga madhësia, por edhe për nga ndikimi i tij.

Sot, Joni Sh posedon fabrikën të pajisur me makineri moderne për paketim dhe ngrirje të frutave dhe është kompania e parë që përveç frutave tradicionale si kajsi, mollë e kumbulla, ka arritur të ofrojë në treg paketime të ngrira të frutave të malit si mjedër, dredhëza, boronicë, manaferrë, etj.

Vit pas viti, ekipi u rrit. Nga një njeri, sot me 25 të punësuar të rregullt të përkushtuar, të cilët nuk janë thjesht të punësuar por shtylla e JONI SH Sh.p.k. Angazhimi dhe përkushtimi i tyre, e shndërroi këtë ndërmarrje në një biznes me storje të veçantë dhe të jashtëzakonshme.

Shpirti ndërmarrës i Albanit nuk u kufizua në kufijtë e biznesit të tij. Duke njohur potencialin e bashkëpunimit dhe simbiozës, ai krijoi partneritete me mbi 30 fermerë vendas të cilët tani u fuqizuan për të kontribuar në vizionin e tij. Këta fermerë sot janë mbi 300 të cilët sjellin produktet e Kosovës, kryesisht mjedra, dhe janë pjesë integrale e një zinxhiri furnizimi që ka arritur të depërtojë edhe në tregjet ndërkombëtare. Kjo lëvizje jo vetëm që rriti rentabilitetin e biznesit, por solli edhe shije të mira të produkteve kosovare në tryezat ndërkombëtare. Duke ofruar gamë të gjerë të frutave me cilësi të lartë sipas standardeve ndërkombëtare ISO, frutat e selektuara me kujdes tani po shijohen nga njerëzit përtej kufijve, duke i lidhur kulturat përmes shijimit të bujarisë së natyrës.

Sot, teksa shikojmë JONI SH Sh.p.k., shohim jo thjesht një biznes, por një dëshmi të potencialit njerëzor dhe fuqisë së ëndrrave. Një ndërmarrje dikur modeste që filloi me vendosmërinë e një njeriu, sot është një emblemë suksesi që ka prekur jetën e individëve të panumërt.

Kjo storje na dëshmon që me pasion, energji, fleksibilitet dhe vizion të qartë, edhe ëndrrat më të guximshme mund të kthehen në realitet që formëson peizazhin e një industrie të tërë.



## REC PLAST

### Biznesi që reciklon 500 tonë mbeturina duke pastruar Kosovën

Fondi Kosovar për Kreditore është i përkushtuar ndaj menaxhimit të qëndrueshëm korporativ dhe ndaj përgjegjësisë sociale. Gjithnjë duke i koordinuar aktivitetet me donatorë, institucione financiare dhe rregullatorët lokalë, mundohemi t'u shërbejmë interesave afatgjate ekonomike të vendit, komunitetit të biznesit dhe shoqërisë sonë në përgjithësi. Prandaj, kësaj rradhe kemi përzgjedhur një biznes të veçantë për këtë tregim suksesi, biznes që kontribon drejtëpërdrejtë në përmirësimin dhe pastrimin e ambientit dhe rrethit ku jetojmë, përmes mbledhjes dhe përpunimit të mbeturinave. Vitomirica, një fshat afër Pejës, regjion i cili shquhet për ajrin e pastër që ia mundëson natyra me pejsazhet e bukura të maleve përreth saj.

Sapo arritëm në fabrikën RecPlast, Shefqeti, babai dhe ideatori i gjithë këtij biznesi na mirëpret ngrohtësisht duke na treguar shumë storje nga jeta e tij interesante. Derisa prisnim të vinte pronari i kompanisë (djali i Shefqetit) Fazqeti, ne kishim mundësinë të shihnim për së afërmi rëndësinë e madhe që ka mbledhja e mbeturinave dhe reciklimi i tyre. Në një hapësirë të gjerë, të mbushur plot mbeturina plastike, hapësirë kjo që kur e paramendon dëmin që shkaktojnë në ambient sikur të ishin ende nëpër hapsirat e Kosovës, të jep të kuptosh shumë më mirë rëndësinë e konceptit të këtij lloji të biznesit.

Të gjitha mbeturinat e grumbulluara aty së pari ndahen dhe klasifikohen që pastaj të procesohen përmes makinës për reciklim, që shndërron mbeturinat në lëndë të parë. Granulat shumëngjyrëshe të plastikës, janë produkti final i përfituar nga një sërë etapash pune. "Ruajtja e ambientit bëhet nga njerëz në nevojë" – ishte deklarata e Fazqetit që nënkupton që mbeturinat i grumbullojnë njerëz që janë të varfër ekonomikisht dhe mbledhjen e mbeturinave e kanë punë primare. Gjë që do të duhej të ishte ndryshe, pra të krijohet kushtet dhe adoptohen politika që do të zhvillojnë dhe mundësoni lehtësira për këtë lloj biznesi. Ne në RecPlast gjatë një viti grumbullojmë dhe eliminojmë 500 tonë mbeturina nga e gjithë Kosova. Pra, puna jonë kontribuon për një Kosovë më të pastër – na tha pronari.

Përmes kredisë së garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, RecPlast ka blerë një makinë të re për reciklim, që do të rris kapacitetin e kompanisë në përpunim dhe reciklim të mbeturinave. Kur kjo përkthehet në sasinë e mbeturinave që do të grumbullohen dhe reciklohen, na tregon ndikimin pozitiv që do ta ketë për një ambient më të pastër në Kosovë.



## LET CENTER

### Një simfoni e të mësuarit brenda botës magjepsëse të Qendrës LET në Prishtinë

Në zemër të Prishtinës, në një lagje të re, arrita në Qendrën LET, ku u mirëprita nga fëmijët e buzëqeshur, stafi miqësor, në shoqërimin e Lidës, udhëheqëses energjike që të mbush pozitivet. Përkushtimi i saj vërehej që në hyrje të Qendrës LET. Së bashku me ekipin e saj, ajo e ka shndërruar këtë qendër në një vend të shenjtë gëzimi dhe mësimi.

Gjatë vizitës në Qendër i shihja në fëmijët të cilët, me plot buzëqeshje, që në fillim të ditës angazhoheshin në një sërë aktivitete të krijuara me kujdes për të ndezur kureshtjen dhe zhvilluar imagjinatën. Klasa e sportit të shahut, klasa e artit, klasa e muzikës, klasat e aktiviteteve të llojllojshme, të dizajnuara me aq kujdes për të krijuar ambient miqësor për fëmijët e moshës 0-6 vjeçe.

Të gjitha këndet e Qendrës LET ishin shndërruar në vende për mësim, lojë e aktivitete, ashtu që të shtohet ndjenja e gëzimit dhe kreativitetit. Duke aplikuar lojëra ndërvepruese dhe mësimet përmes lojërave të shumta, edukatorët përfshiheshin me zemër në formësimin e mendjeve të fëmijëve, duke mbjellë dashuri të veçantë për të nxëniet dhe të mësuarit që nuk njih kufij.

“Këtu ku jemi sot kemi arritur me shumë punë dhe përkushtim, së bashku me të gjithë punonjësit e Qendrës LET” – na tha Lida, pronarja/udhëheqësja e kësaj qendre edukimi.

Fillimet e secilit biznes janë të vështira, por, me vendosmëri, ide origjinale dhe përkushtim maksimal, kemi arritur ta hapim këtë qendër, e cila sot ka kapacitet për të pranuar deri në 120 fëmijë. Qasja në financim nuk është fare e lehtë për gratë. Shpeshherë, jemi kategori e shërbyer më pak për sa i përket financimit, meqë nuk kemi prona në emrin tonë. Por, falë bashkëpunimit afatgjatë që kemi krijuar me bankën dhe falë garantimit të kredisë nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, kemi arritur ta zgjerojmë biznesin dhe tani, bashkë me Fitoren, motrën time, i kemi dy qendra edukimi për fëmijë, vazhdoi Lida.

Sikurse çdo biznes tjetër, edhe ky lloj biznesi i ka veçoritë dhe sfidat e veta. Ne të gjithë jemi të ndjeshëm kur bëhet fjalë për fëmijët dhe edukimin e tyre. Si qendër edukimi, duhet të përçojmë mirëbesim te prindërit, t'i plotësojnë pritjet e tyre, si për nga aspekti përmbajtësor ashtu edhe në ofrimin e kushteve dhe mjedisit cilësor e miqësor për fëmijët.

“Në këtë mënyrë, prindërit na besojnë dhe ndjehen rehat gjatë kohës sa fëmijët janë në qendrën tonë”, tha Lida.

Sot në qendrën tonë i kemi 15 edukatorë dhe 65 fëmijë që vijojnë mësimin, të moshës nga 0 deri 6 vjeç. Do të vazhdojmë të jemi qendër arsimit për fëmijët, ku të gjithë do ta ndjejnë sigurinë, mirëqenien dhe profesionalizmin tonë. Do të zgjerohemi edhe më tutje, ashtu që fëmijëve t’ju mbjellim dashurinë për artin, muzikën, edukatën fizike, diturinë e kreativitetin, që të mbjellim farën e mendimit kritik në mënyrë që gjeneratat e reja të kenë prosperitet.



## SCAMPA

### Rrugëtimi i kompanisë të prodhimeve të plastikës “Scampa”

Në zemër të Parkut Industrial në Drenas, një biznes tanimë i konsoliduar ishte shfaqur në vitin 2006 si biznes fillestar me ëndrra të mëdha. Nga një ndërmarrje modeste, shumë shpejt dhe bindshëm u shndërrua në kompani të arrirë, falë vizionit dhe energjisë së themeluesit të saj, Kujtim Gjevori. Si çdo biznes, në fillimet e veta “Scampa” u përball me sfida të shumta tipike për startup-et – burime të kufizuara, konkurrencë, si dhe me dinamikën e ndryshueshme të tregut. Megjithatë, i nxitur nga dëshira, ambicia dhe përkushtimi ndaj cilësisë, Kujtimi ishte këmbëngulës në vizionin e tij. Me një ekip të përkushtuar, i cili sot përbëhet nga 50 punonjës, u fokusua në rafinimin e proceseve të prodhimit dhe zgjerimin e gamës së produkteve.

Një nga pikat kryesore të kthesës erdhi kur kompania përqafoi inovacionin dhe investoi në teknologjinë më të fundit të përpunimit të plastikës për prodhim të qeseve me dizajne të personalizuar dhe printim me cilësi të lartë, duke u dalluar nga konkurrentët dhe duke filluar të eksportonin edhe jashtë vendit, në SHBA dhe Evropë. Duke njohur potencialin e tregjeve jashtë shtetit, synimet e këtij biznesi për zgjerim targetuan në mënyrë strategjike sidomos vendet evropiane si Holanda dhe Belgjika, të njohura për standardet e tyre të rrepta të cilësisë dhe bazën e konsumatorëve të ndërgjegjshëm për mjedisin. Këtë a arritën duke lidhur partneritet bashkë-investimi me kompani Belge dhe nëpërmjet planifikimit të përpiktë dhe cilësisë, arritën të depërtojnë me sukses në këto tregje, duke fituar besimin e klientëve. Qasja dhe kultura e punës që praktikohet në “Scampa” ka nxitur inovacion dhe përmirësim të vazhdueshëm, si në cilësi ashtu edhe kushteve të punës, duke siguruar që kjo kompani të jetë e dalluar në këtë industri. Me investimet në makineri të reja me kapacitete më të mëdha përmes financimit nga bankat, si dhe me garantimin e një pjese të financimit nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore përmes dritares së eksportit që përkrah bizneset eksportuese, rrugëtimi i synuar i këtij biznesi u bë realitet.

Produktet e prodhuara nga Scampa përbëhen nga materialet e ripërdorshme duke filluar prej 80% mbetje PCR (Post Consumer Recycled ose materiali i ricikluar pas konsumit). Pra, i gjithë materiali, në vend që të dërgohet në deponi, ripërdoret dhe i jepet një formë dhe jetë e re. Pronari i kompanisë na tha se: “Duke përdorur mbetjet PCR në produktet tona, e kemi reduktuar gjurmën e karbonit në mjedis dhe promovojmë qëndrueshmëri. Duke zbatuar qarkun e mbyllur, që nënkupton të gjitha mbetjet e prodhuara në fabrikën tonë gjatë prodhimit riciklohen dhe kthehen në produkt final, riciklimi si dhe projekt i ri në vazhdim e sipër është edhe përdorimi i materialeve të biodegradueshme janë praktika miqësore ndaj mjedisit”.

Sot, ky prodhues dikur i vogël i qeseve të plastikës, qëndron si shembull i ndritshëm i suksesit ndërmarrës. Me themele të forta, ekip të talentuar dhe një udhëheqës vizionar në krye, ata vazhdojnë të depërtojnë jashtë kufijve të Kosovës dhe të eksplorojnë vazhdimisht mundësi të reja për rritje.

Teksa punojnë drejt së ardhmes, një gjë është e sigurt – rrugëtimi i këtij biznesi vendas i ka dyert e hapura drejt më shumë kapitujve të tjerë të sukseseve që ende nuk janë shkruar, por që do të shkruhen në të ardhmen.



# PJESA VIII

The background features several overlapping, wavy, organic shapes in shades of teal and light blue. These shapes create a sense of movement and depth, with some areas appearing more saturated than others. The overall aesthetic is clean and modern.



PASQYRAT  
FINANCIARE TË  
AUDITUARA

**FONDI KOSOVAR PËR GARANCI  
KREDITORE**

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare për vitin që ka  
përfunduar më 31 Dhjetor 2023**



## **PËRMBAJTJA**

	<b>Faqe</b>
<b>Raporti i Auditorit të Pavarur</b>	<b>1</b>
<b>Pasqyra e Pozicionit Financiar</b>	<b>3</b>
<b>Pasqyra e Fitimit apo Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse</b>	<b>4</b>
<b>Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet</b>	<b>5</b>
<b>Pasqyra e Rrjedhës së Parasë</b>	<b>6</b>
<b>Shënimet e Pasqyrave Financiare</b>	<b>7-42</b>
<b>Shtojca 1 - Transaksionet e Projektit për Mbështetje dhe Forcim Financiar</b>	<b>43</b>

## RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

### Për Bordin e Drejtorëve të Fondit Kosovar Për Garanci Kreditore

#### Raport i auditimit të Pasqyrave Financiare

##### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit Kosovar Për Garanci Kreditore ("Fondi" apo "FKGK"), që përfshinë: Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2023, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar dhe shënimet e pasqyrave financiare, duke përfshirë edhe një përmbledhje të informatave për politikatat materiale të kontabilitetit.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Fondit më 31 Dhjetor 2023, dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që kanë përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

##### Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit *Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

##### Raportimi për informacione të tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informacione të tjera të shpalosura në Aneksin 1 të këtyre pasqyrave financiare. Informacioni tjetër përbëhet nga grafiku që shpalos bilancet dhe transaksionet me Bankën Botërore.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacione të tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë të konkluzionit të sigurisë mbi to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër dhe duke e bërë këtë të shqyrtojmë nëse informacioni tjetër është materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose ndryshe duket të jetë materialisht i gabuar.

##### Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Fondit për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Fondin apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

## Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushtet që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësimi i prezantimit në përgjithësi, strukturës dhe përmbajtjes së pasqyrave financiare, duke përfshirë informatat e paraqitura, si dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në atë mënyrë që përbënë prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Ky raport në Shqip është version i përkthyer i origjinalit në gjuhën Angleze, në rast të mospërputhjeve, origjinali në Anglisht do të mbizotëroj.



Amir Dërmata  
Partner i Angazhimit  
BDO Kosova L.L.C.  
25 Qershor 2024  
Ukshin Hoti, Ndërtesa C 4/3, Hyrja. A, Kati 2,  
Prishtinë, Kosovë

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore  
Pasqyra e Pozicionit Financiar  
Më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat në EUR, përveç nëse theksohet ndryshe)

		Më 31 Dhjetor 2023	Më 31 Dhjetor 2022
	<b>Shënime</b>		
<b>PASURITË</b>			
Prona, impiantet dhe pajisjet	9	38,234	30,954
Pasuritë e paprekshme	10	22,147	17,509
Pasuritë me të drejtë përdorimi	8	22,210	41,248
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>		<b>82,591</b>	<b>89,711</b>
Depozitat	6	55,932,554	42,174,250
Investimet në letra me vlerë	7	22,926,628	18,781,139
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	5	335,651	282,333
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	8,668,321	2,052,322
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>		<b>87,863,154</b>	<b>63,290,044</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>87,945,745</b>	<b>63,379,755</b>
<b>EKUITETI DHE DETYRIMET</b>			
Kapitali	13	76,932,511	54,300,921
Fitimi i akumuluar		4,360,451	3,434,390
<b>Gjithsej ekuiteti</b>		<b>81,292,962</b>	<b>57,735,311</b>
Shpenzimet akruale		101,434	11,553
Detyrimet e qirasë	8	24,920	44,891
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>126,354</b>	<b>56,444</b>
Rezervat e humbjeve nga garancionet e kredive	19	4,566,250	3,021,000
Të hyrat e shtyra	11	829,840	1,346,980
Tarifat akruale të garancisë	12	1,130,339	1,220,020
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>6,526,429</b>	<b>5,588,000</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>6,652,783</b>	<b>5,644,444</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>87,945,745</b>	<b>63,379,755</b>

Autorizohet për lëshim nga menaxhmenti dhe nënshkruar në emër të tij më 25 Qershor 2024.

  
Besnik Berisha  
Drejtor Menaxhues



  
Vjosa Balaj  
Menaxhere e Lartë e Financave

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 41 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore  
Pasqyra e Fitimit apo Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse  
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023  
*(të gjitha vlerat në EUR, përveç nëse theksohet ndryshe)*

		Për vitin që përfundon 31 Dhjetor 2023	Për vitin që përfundon 31 Dhjetor 2022
	<b>Shënime</b>		
Të hyra nga garancionet	14	2,374,801	2,457,527
Te hyra nga interesi	15	1,209,007	855,819
Të hyra tjera	16	474,325	368,359
<b>Fitimi bruto</b>		<b>4,058,133</b>	<b>3,681,705</b>
Shpenzimet e personelit	17	(335,474)	(287,630)
Shpenzimet operative	18	(262,596)	(297,530)
Shpenzimet e zhvlerësimit	9,10	(23,626)	(21,155)
Zhvlerësimi ROU	8	(19,038)	(19,038)
Neto provizionet për humbje nga garancionet	19	(2,397,124)	(269,387)
Neto provizionet për humbje nga pasuritë tjera	19	(91,985)	34,531
<b>Gjithsej shpenzimet</b>		<b>(3,129,843)</b>	<b>(860,209)</b>
Shpenzimet e detyrimeve të qirasë		(2,229)	(3,430)
<b>Neto fitimi për vitin</b>		<b>926,061</b>	<b>2,818,066</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>926,061</b>	<b>2,818,066</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 41 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

**Fondi Kosovar për Garanci Kreditore**  
**Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet**  
**Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023**  
*(të gjitha vlerat në EUR, përveç nëse theksohet ndryshe)*

	Kapitali	Fitimi i akumuluar	Gjithsej
Bilanci më 1 Janar 2022	54,300,921	616,324	54,917,245
Neto fitimi për vitin	-	2,818,066	2,818,066
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2022</b>	<b>54,300,921</b>	<b>3,434,390</b>	<b>57,735,311</b>
Bilanci më 1 Janar 2023	54,300,921	3,434,390	57,735,311
Neto fitimi për vitin	-	926,061	926,061
Kapitali i paguar	22,631,590	-	22,631,590
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2023</b>	<b>76,932,511</b>	<b>4,360,451</b>	<b>81,292,962</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 41 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

**Fondi Kosovar për Garanci Kreditore**  
**Pasqyra e Rrjedhës së Parasë**  
**Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023**  
*(të gjitha vlerat në EUR, përveç nëse theksohet ndryshe)*

	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2023	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2022
<b>Aktivitetet operative</b>		
Neto profiti për vitin, para tatimit	926,061	2,818,066
<i>Rregullimet për:</i>		
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	42,664	40,193
Humbjet nga shitja e pasurive	-	108
<b>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues</b>	<b>968,725</b>	<b>2,858,367</b>
Rritja në të arkëtueshme tregtare dhe tjera	(53,318)	(56,625)
Rritja/(zvogëlimi) në shpenzimet akruale	89,881	(1,543)
Ndryshimi në të hyrat e shtyra	(517,140)	(910,478)
Ndryshimi në akrualet e tarifave të garancisë	(89,681)	(106,566)
<b>Paraja neto e gjeneruar në aktivitetet operative</b>	<b>398,467</b>	<b>1,783,155</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Rritja në depozita	(13,758,304)	(5,038,340)
Rritja në letra me vlerë	(4,145,489)	(4,194,717)
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve	(35,544)	(27,579)
Ndryshimi në rezervën për humbjet nga garancionet	1,545,250	(303,217)
Ndryshimi në rezervën për humbjet nga pasuritë tjera	-	(34,531)
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese</b>	<b>(16,394,087)</b>	<b>(9,598,384)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Zvogëlimi në detyrimet e qerasë	(19,971)	(18,770)
Kapitali i paguar	22,631,590	-
<b>Paraja neto e gjeneruar/(përdorur) në aktivitetet financuese</b>	<b>22,611,619</b>	<b>(18,770)</b>
<b>Rritja/(zvogëlimi) i parasë dhe ekuivalentëve të parasë gjatë vitit</b>	<b>6,615,999</b>	<b>(7,833,999)</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë, fillimi i vitit	2,052,322	9,886,321
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë, fundi i vitit</b>	<b>8,668,321</b>	<b>2,052,322</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 41 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

## 1. TË PËRGJITHSHME

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ("FKGK" ose "Fondi") është institucion i pavarur dhe i qëndrueshëm që lëshon garanci për institucionet financiare për të mbuluar rrezikun për kreditë e NMVM-ve (Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme).

FKGK u krijua, përmes të një iniciative të përbashkët midis Donatorëve Ndërkombëtarë në Kosovë (kryesisht USAID dhe KfW) dhe Qeverisë së Kosovës, në Janar 2016, bazuar në Ligjin për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Ligji për Themelimin e Fondit Kosovar të Garancisë Kreditore" (Ligji nr. 05/L-057), tutje referuar si LKCGF, krijoi Fondin Kosovar të Garancisë Kreditore (FKGK) si një institucion publik, autonom, jofitimprurës me personalitet të plotë juridik. Ky ligj e ndan në mënyrë të qartë identitetin ligjor të FKGK-së nga Bordi i Drejtorëve dhe Ekzekutivëve të tij. LKCGF gjithashtu përcakton autoritetin, strukturën, qeverisjen, operacionet, fushëveprimin, politikat dhe procedurat e FKGK-së për lëshimin e garancive kreditore.

Ligji për themelimin e FKGK-së u inicua nga MTI (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë), ndërsa USAID në Kosovë, përmes Programit EMPOWER Mbështetja e Kredisë (ECS) mbështeti institucionin për t'u bërë funksional. Ligji hyri në fuqi më 23 Janar 2016. Kapitali i FKGK-së përbëhet nga fonde të dhuruara nga USAID, KfW dhe Qeveria e Kosovës.

FKGK është krijuar për të ndihmuar në plotësimin e nevojës për qasje të shtuar në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjes së prodhimit vendor dhe shërbimeve të shtuara me vlerë, dhe përmirësimit të bilancit tregtar dhe rritjes së mundësive të financimit për NMVM-të.

FKGK udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve i përbërë nga shtatë anëtarë: Një anëtar i emëruar sipas detyrës zyrtare nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Republikës së Kosovës; Një anëtar i emëruar sipas detyrës zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës; katër anëtarë të pavarur, të emëruar nga donatorët, dhe Drejtori Menaxhues i FKGK-së, të cilët së bashku kombinojnë vite përvojë në menaxhimin financiar, menaxhimin e rrezikut, ligjin komercial ose financiar, sektorin privat dhe auditimin. Bordi ofron udhëheqje dhe mbikëqyrje për të gjitha aktivitetet e FKGK-së.

FKGK-ja është themeluar me qëllim të sigurimit të pjesshëm të garancive të kredive për institucionet financiare, për kreditë që i jepen NMVM-ve, deri në shumën e mbulimit garancioneve të kredive të përcaktuar me LFKGK dhe Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet FKGK-së dhe institucionit financiar.

Për qëllimet e veprimtarisë kryesore, FKGK-ja është përgjegjëse për:

- a. Lëshimin e Garancive Kreditore në përputhje me LFKGK-në dhe politikat e brendshme të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.
- b. Vendosjen e kushteve për regjistrimin e institucioneve të kualifikuara financiare në FKGK, sipas Politikës për Regjistrimin e Institucioneve Financiare Caktimin e kushteve për lëshimin e Garancive Kreditore nga FKGK-ja.
- c. Caktimin e kushteve për lëshimin e Garancive Kreditore nga FKGK-ja
- d. Caktimin e Tarifave të Garancive
- e. Depozitimin apo investimin e drejtpërdrejtë, apo përmes delegimit të autorizimeve, të aseteve të FKGK-së brenda kufizimeve të LFKGK-së
- f. Pagesën e Shumave të pagueshme për Garancitë Kreditore për institucionet financiare të regjistruara në pajtim me dispozitat e LFKGK-së dhe Marrëveshjes së Garancisë, në përputhje me dispozitat e LFKGK-së dhe Politikave për Trajtimin e Kërkesave.



## **1. TË PËRGJITHSHME (VAZHDIM)**

Kapitali minimal i FKGK-së është 300,000.00 Euro, sipas nenit të 10 të LFKGK (Ligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore). Organet qeverisëse të FKGK-së janë Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues. Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë drejtues i FKGK-së. Numri fiskal i FKGK-së është 601642061.

Operacionet e FKGK-së dhe të gjitha aktivitetet administrative janë të pavarura që nga data 10 qershor 2017 dhe janë nën menaxhimin e Fondit.

Më 6 Dhjetor 2017 Fondi për Garantimin e Kredive të Kosovës (FKGK) nënshkroi Marrëveshjen e Garancisë me Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë. Më 14 maj 2019 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) nënshkroi Marrëveshjen e Garancisë me Fondin Evropian Investues nën programin COSME LGF (loan guarantee facility). Më 11 maj 2022, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) nënshkroi Marrëveshjen e Garancisë së portofolit me Korporatën Financiare për Zhvillim (DFC). Më 30 nëntor 2023, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) nënshkroi Marrëveshjen e dytë të Garancisë me Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë.

Mbështetja e portofolit të garantuar të FKGK-së nga Sida dhe COSME, dhe DFC do të rrisë më tej aftësinë e Fondit për të siguruar një nivel më të lartë të garancive të kredisë, duke rritur në të njëjtën kohë qëndrueshmërinë financiare të sektorit. Qëndrueshmëria do të reflektojë në lehtësimin e ndërmjetësimit financiar, duke rritur kështu qasjen në financimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, me qëllim të promovimit të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të punës për gra, burra dhe të rinjtë e të gjitha etnive në Kosovë.

## **2. INFORMACION PËR POLITIKAT MATERIALE TË KONTABILITETIT**

### **2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), siç janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Pasqyrat financiare janë përgatitur me anë të bazave të vlerësimit të specifikuar nga SNRF-ja për çdo lloj aset, detyrimi, të ardhurash apo shpenzimesh. Bazat e vlerësimit janë të përshkruara në hollësi në Shënimin si me poshtë. Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-në kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike të kontabilitetit. Gjithashtu kërkon nga menaxhmenti të shfrytëzojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Fondit. Fushat ku janë bërë gjykime dhe vlerësime të rëndësishme gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare dhe efektet e tyre shpalosen në shënimin 3.8.

#### **2.1.1 *Adoptimi i Standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimi i tyre***

